




CH RO NIC LES

VOL. 1

Viti Akademik 2025-2026



“Krijimtaria është inteligjenca që argëtohet.” - Albert Einstein

Me shumë entuziazëm hapim këtë dritare të re që t’ju ofrojmë të përjetoni çdo emocion nga aktivitetet, koncertet, ekspozitat dhe dinamikat e sezonit ku do të lexoni historitë më të bukura të studentëve gjatë këtij rrugëtimi akademik, mendimet e mentorëve, intervista me të rinjt dhe artikuj nga ngjarjet më të rëndësishme.

Fjala e studentëve te revistës:

Ky numër i parë nuk është thjesht një fillim, por një gur themeli për një histori të trashëgueshme që do të mbetet gjallë për brezat që vijnë në Universitetin European të Tiranës.

PËRMBAJTJA

1. Fjala e Rektores – Prof. Dr. Drita Kruja (fq.6)
2. Parathënie për revistën
Dokt. Kristi Bello, Dekani i Studentëve,
UET (fq.8)
3. Dokt. Erisela Marko për UET
Chronicles (fq.11)
4. Masterclass me Adi Krastën: Kur
Gazetaria e Vërtetë Takoi Studentët e
UET-së (fq.14)
5. Dy Klube, Një Mision: Të Dhurojmë
Buzëqeshje (fq.18)
6. “Fjala që dhuron botë”: Studentët e
UET u Dhuruan Fëmijëve një Botë të Re
(fq.22)
7. Klubi i Arteve Vizuale – Nga
Krijimtaria në Angazhim Pedagoge
mentoruese: Dr. Blegina Hasko Bezo
(fq.26)
8. Balada e një djali të mirë dhe një djali
të keq”: Kur Studentët e UET Vënë në
Skënë Moralin (fq.29)

9. “Propozimi i Pulëbardhës”: Kur një Provim u Shndërrua në Magji Skenike (fq.35)
10. Klubi i Arteve - Hapësira ku Imagjinata merr Jetë Pedagogu mentorues: Dokt. Kristi Bello (fq.40)
11. Klubi i Arteve: Teater - Dritan Boriçi (fq.42)
12. Studentët e UET në Burgun e Spaçit: Kur Arti Takon Historinë (fq.43)
13. Besian Zogaj- mentori i Klubit Russel (fq.48)
14. Kur Arti Takon Mjekësinë: Një Dialog përtej Fjalëve.“Diagnoza: Art – Një laborator i terapisë së artit përmes filtrit klinik” (fq.53)
15. Intervista me Mentorin e Klubit “Hipokrati”- Kristi Çela (fq.58)
16. Klubi i Letërsisë: Kadare - Ermir Nika (fq.62)
17. Fjalet e mentores se Klubit “John Locke”, Dr. Sofjana Veliut (fq.65)

18. Aktivitet “Ditët e Hapura” në Gjykatën Kushtetuese. Nga mentorja e klubit “John Locke” Sofjana Veliu (fq.71)
19. Klubi i Inxhinierisë “Nikola Tesla”Pedagogu Mentorues: Jani Petro (fq.75)
20. Fjalet e mentorit te klubit te sportit “Uet Sport Club”, Dr. Marjo Shabanaj (fq.81)
21. Fjalet e mentores se Klubit te Inovacionit “Steve Jobs”, Dr. Malvina Niklekaj: Një vit i mbushur me teknologji, kreativitet dhe sfida (fq.85)
22. Workshop “Upcycling”: Kur Materialet e Vjetra Gjejnë Jetë të Re (fq.90)
23. Fjalet e mentores se Klubit te Arkitekturës dhe Dizajnit “Le Corbusier” , Dr.Enkeleida Prifti (fq.94)
24. Fjalet e mentores se Klubit te Finances “Adam Smith” Dr. Grisejda Myslymi,Nga Auditori në Praktikë: Një Vit Aktiv me Klubin Studentor “Adam Smith” (fq.98)

25. Forumi i Studentëve të Financës:
Kur Studentët e UET Analizojnë Tregjet Globale (fq.102)
26. Intervista me Mentoren e Klubit të Psikologjise "Freud"-Redona Dudushi,Aty ku psikologjia kthehet në mbështetje dhe zhvillim (fq.106)
27. Intervista me Mentoren e Klubit të Menaxhimit "Peter Drucker"-Mishela Rapo (fq.110)
28. Kur Teknologjia Takon Ambicien e Grave. Dita Ndërkombëtare e Vajzave në ICT (fq.120)
29. Trajnimi i OSBE-së për Barazinë Gjinore: Kur Stereotipet Përballen me Faktin (fq.127)
30. Java Ndërkombëtare Erasmus+: Kur Botët Bashkohen në një Kampus (fq.131)
31. UET mirëpret Erasmus+ Days dhe International Staff Week (fq.135)
32. Zanafilla e DITURIUM Media Lab (fq.140)

FJALA E REKTORTES

- PROF. DR. DRITA KRUJA



Klubet studentore kanë një rol të veçantë në krijimin e një komuniteti universitar më aktiv, më të gjallë dhe më bashkëpunues. Ato i japin studentëve mundësinë të shprehin idetë, talentet dhe interesat e tyre, të marrin përgjegjësi, të punojnë në grup dhe të zhvillojnë aftësi që plotësojnë formimin akademik.

Ato forcojnë lidhjen mes studentëve, pedagogëve dhe mentorëve, nxisin bashkëpunimin ndërmjet programeve të studimit. Ato krijojnë një kulturë universitare ku studentët nuk janë vetëm

pjesëmarrës, por edhe bashkëkrijues të jetës akademike dhe sociale në UET.

“UET Chronicles” është një dëshmi e kësaj fryme. Revista pasqyron jo vetëm aktivitetet, por edhe historitë, emocionet dhe përvojat që e bëjnë jetën universitare më të pasur dhe më kuptimplote. Përmes saj studentët e Komunikimit tregojnë se kanë aftësinë të vëzhgojnë, të dokumentojnë dhe të komunikojnë me profesionalizëm realitetin universitar.

Mesazhi im për studentët që kanë punuar për këtë revistë : vijoni të jeni kureshtar, krijues dhe të guximshëm në idetë tuaja. Një universitet zhvillohet më shumë kur studentët marrin pjesë aktivisht në jetën e tij.

Uroj që “UET Chronicles” të kthehet në një traditë të qëndrueshme studentore, ku çdo vit të dokumentohen me përkushtim dhe kreativitet momentet, arritjet dhe historitë.

Përgatiti:

Nejla Mjeshtri

Fakulteti i Shkencave Politike, Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare

Profili: Studime Europiane

Studente e vitit të tretë

Parathënie për revistën

Dokt. Kristi Bello

Dekani i Studentëve, UET



Kur ecën korridoreve të UET-it, gjëja e parë që ndjen është një lloj energjie që nuk ka të bëjë vetëm me leksionet apo seminarët që studentët ndjekin në UET. Vjen nga idetë e studentëve, nga bisedat pas leksioneve dhe nga dëshira për të bërë diçka ndryshe. Prandaj, jam shumë i lumtur që sot po shfletojmë numrin e parë të revistës së klubeve tona studentore, një projekt që vjen për herë të parë dhe plotësisht i realizuar nga vetë studentët.

Gjithçka nisi nga një ide në takimet e

Mentorëve të Klubeve, me Rektoren e UET, Prof. Dr. Drita Kruja dhe Klubi i Komunikimit “McLuhan”, nën udhëheqjen e pedagoges mentoruese Erisela Marko bashkë me studentët e këtij klubi morën guximin dhe u bënë drejtuesit e kësaj nisme, duke treguar se komunikimi është ura që lidh çdo fushë, nga marketingut e juridiku e deri te shkencat e tjera në universitet.

Klubet studentore në UET kanë qenë gjithmonë ajo “hapësira ndryshe” ku mund të jesh vetvetja dhe të mbushesh me energji. Këto organizime janë ndërtuar posaçërisht që studentët të plotësojnë formimin e tyre akademik duke u argëtuar, duke marrë një orientim për karrierën dhe duke fituar ato aftësi njerëzore që i bëjnë gati për jetën. Ky projekt tregon se auditori nuk mjafton asnjëherë dhe se zhvillimi i vërtetë vjen kur mendimi “ngacmohet dhe rrjetëzohet”.

Në faqet e kësaj reviste nuk do të gjeni rregulla apo përshkrime të thata. Aty do të ndjeni pulsin e vërtetë të jetës studentore: do të shihni se si miqtë bashkohen përmes sportit; si eksplorohet arti, muzika e teatri; dhe si mendjet krijuese guxojnë të shkojnë drejt inovacioneve në mjekësi, IT, arkitekturë apo inxhinieri. Kjo revistë është

një rrëfim ku shkrihen bashkë praktikat e biznesit dhe financës, diskutimet kritike për letërsinë, debatet ligjore dhe analizat për shoqërinë e psikologjinë e njeriut. Të gjitha këto zëra bëhen bashkë për të treguar se sa rëndësi ka të punosh në grup, të jesh empatik, të komunikosh hapur dhe të rritësh inteligjencën emocionale.

Si Dekan i Studentëve, nuk ka kënaqësi më të madhe sesa të shohësh studentët që realizojnë projektet e tyre me kaq kreativitet. Kjo revistë është prova më e mirë se studentët tanë janë gati të japin idetë e tyre dhe të lenë gjurmën e tyre në universitet.

Le ta lexojmë këtë revistë me të njëjtin kuriozitet dhe dëshirë me të cilën studentët tanë e kanë krijuar, të frymëzohemi nga energjia e tyre dhe të zbulojmë botën e bukur të klubeve tona studentore.

Shumë suksese në këtë rrugëtim dhe lexim të mbarë të gjithëve!

Përgatitur nga: Grejsi Xhani

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale,

Departamenti i Arteve të Aplikuara , profil “ Aktrim” .

Studente e vitit të dytë

AS201

Dokt. Erisela Marko për UET Chronicles



Si mentore e Klubit të Komunikimit “McLuhan”, jam veçanërisht e lumtur për një nga nismat më të rëndësishme që kemi ndërmarrë këtë vit akademik: krijimin e revistës studentore UET Chronicles.

Kjo revistë është konceptuar si një platformë e studentëve dhe për studentët, ku ata kanë mundësinë të shprehen lirshëm, të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe të provojnë në praktikë njohuritë që marrin në auditor. Përmes saj, studentët kanë mundësinë të

intervistojnë pedagogë, të trajtojnë tema me interes, të raportojnë aktivitete universitare dhe të sjellin këndvështrimin e tyre mbi jetën akademike dhe shoqërore. Sigurisht, çdo material kalon në proces redaktimi dhe verifikimi përpara publikimit, duke i njohur studentët edhe me standardet profesionale të gazetarisë dhe komunikimit.

Ajo që e bën UET Chronicles edhe më të veçantë është fakti se çdo element i saj është rezultat i punës së studentëve. Ata kanë kontribuar në dizajnin e revistës, përzgjedhjen e ngjyrave, krijimin e logove, realizimin e fotografive, shkrimin e artikujve, zhvillimin e intervistave dhe në çdo detaj tjetër që përbën identitetin e këtij publikimi. Kjo e kthen revistën në një laborator të vërtetë praktik, ku talenti, kreativiteti dhe puna në grup gjejnë hapësirën e duhur për t'u zhvilluar.

Ky është viti i parë që Klubi i Komunikimit realizon një projekt të tillë, por synimi ynë është që UET Chronicles të shndërrohet në një traditë të qëndrueshme. Çdo vit, studentë të rinj do të kenë mundësinë të kontribuojnë, të publikojnë punën e tyre dhe të lënë gjurmën e tyre në historinë e këtij publikimi.

Njëkohësisht, revista shërben si një urë komunikimi mes të gjitha klubeve studentore të universitetit. Përmes saj promovohen aktivitetet, projektet dhe iniciativat e ndryshme që zhvillohen në UET, duke krijuar një pasqyrë më të plotë të jetës studentore. Për të rinjtë që dëshirojnë të bëhen pjesë e UET-it në të ardhmen, UET Chronicles ofron një mundësi për të parë nga afër energjinë, angazhimin dhe aktivitetet që karakterizojnë studentët tanë.

Besoj se kjo iniciativë jo vetëm që pasuron jetën universitare, por krijon edhe një hapësirë të rëndësishme për zhvillimin profesional të studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat e komunikimit dhe medias në të ardhmen.

Nuk mund të them apo të shkruaj me gjatë në lidhje me aktivitetet e klubit të komunikimit “McLuhan”, sepse kjo gazetë studentore flet më shumë se sa do të thosha unë.

Masterclass me Adi Krastën:

Kur

Gazetaria

e vërtetë

Takoi

Studentët

e UET

15.05.2024

16.05.2024

17.05.2024

18.05.2024

19.05.2024

20.05.2024

Në ambientet e Concilium, një diskutim i hapur dhe interaktiv i dha studentëve mundësinë të ndiqnin nga afër një prej zërave më të njohur të medias shqiptare. Adi Krasta ishte i ftuari special i masterclass-it “Dje, Sot dhe Nesër”, një aktivitet që ktheu vëmendjen nga notat dhe tek realiteti i vërtetë i gazetarisë.



Nga “dje” tek “nesër”: Si ka ndryshuar media?

Që në nisje, studentët shfaqen kuriozitet për eksperiencën shumëvjeçare të Krastës në televizion. Pyetjet nuk u ndalën tek karriera ata donin të dinin se si funksionon realisht media shqiptare, çfarë presionesh përjetojnë gazetarët dhe çfarë i pret të rinjtë që duan të hyjnë në këtë profesion. Krasta foli për ndryshimet drastike që ka kaluar media ndër vite, duke krahasuar gazetarinë e dikurshme me realitetin e sotëm dhe sfidat që sjell epoka digjitale, ku informacioni vrapon më shpejt se verifikimi.

A është media e lirë? Pyetja që ndezi debatin

Një nga momentet më të forta të diskutimit erdhi kur një studente e pyeti nëse gazetarët ndihen realisht të lirë për të raportuar. Përgjigja e Krastës ishte e drejtpërdrejtë dhe reflektuese: media nuk mund të jetë plotësisht e lirë për aq kohë sa vetë shoqëria nuk arrin të jetë e lirë. Ai pranoi se gazetarët shpesh përballen me kufizime, presione dhe ndikime nga struktura të brendshme apo interesa të caktuara një realitet që studentët duhet ta njohin para se të hyjnë në këtë botë.

Këshilla për brezin e ri

Përtej analizave, Krasta iu drejtua studentëve me këshilla praktike: autenticiteti, mendimi kritik dhe përkushtimi mbeten armët më të forta të çdo gazetari. Në një treg ku shpejtësia dhe klikimet shpesh e marrin vendin e thellësisë, ai kërkoi për të mbajtur integritetin profesional brenda presionit. Ai theksoi gjithashtu përgjegjësinë që ka gazetaria në formimin e opinionit publik një peshë që profesionistët duhet ta ndiejnë çdo ditë.

Çfarë morën me vete studentët?

Masterclass-i nuk ishte thjesht një ligjëratë. Ishte një hapësirë ku idetë, pyetjet dhe dilemat mbi median morën një dimension më realist. Studentët u larguan jo vetëm me përshtypje nga karriera e Krastës, por me një kuptim më të qartë se gazetaria e mirë kërkon diçka më shumë se talent kërkon guxim të vazhdueshëm për të thënë të vërtetën, edhe kur ajo nuk është e lehtë.



Përgatitur nga:

Irini Tollumi,

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve
Liberale,

Departamenti i Shkencave Humane dhe
Komunikimit, profil “Marketing”

Studente e vitit të dytë

KOM201

Dy Klube, Një Mision: Të Dhurojmë

Buzëqeshje.

Në kuadër të 1 Qershorit, Klubi i Arteve Pamore dhe Klubi i Komunikimit në UET zhvilluan një aktivitet humanitar që la gjurmë. Nën drejtimin e mentoreve Erisela Marko, Blegina Bezo Hasko dhe me mbështetjen e Kristi Bello, studentët u nisën drejt Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli” me një synim të vetëm: të sillnin gëzim.



Solidariteti para se të nisej

Përpara ditës së aktivitetit, studentët e UET iu përgjigjën thirrjes me gatishmëri të plotë. Ata mbledhën veshje verore, mjete shkollore, materiale për pikturë, lodra, libra dhe dhurata të tjera të përshtatura sipas moshës së secilit fëmijë. Në “Zyber Hallulli” ndodhen 39 fëmijë, dhe falë këtij angazhimi, secili prej tyre mori një dhuratë të përzgjedhur me kujdes.



Përgatitur nga:

Irini Tollumi,
Fakulteti i Shkencave Humane,
Edukimit dhe Arteve Liberale,
Departmenti i Shkencave Humane
dhe Komunikimit, profil "Marketing"
Studente e vitit të dytë
KOM201

“Fjala që dhuron botë” :



Studentët e UET u Dhuruan Fëmijëve një Botë të Re



Në një botë që lëviz me ritme të shpejta, ka gjithmonë nevojë për dikë që të të kujtojë magjinë e fjalës dhe imagjinatës... Studentët e Fakultetit të Arteve dhe klubit të Komunikimit të UET, së bashku me Dekanin e Studentëve, organizuan aktivitetin “Fjala që dhuron botë” për fëmijët e Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli” një ditë ku libri u bë urë mes ëndrrave dhe realitetit.

Kur libri vjen si mik i heshtur

Aktiviteti synonte të afrojë fëmijët me botën e leximit përmes bashkëbisedimeve të hapura, ndarjes së librave me dedikime personale dhe momenteve frymëzuese. Për shumë prej tyre, kjo ishte një mundësi për të zbuluar se libri nuk është thjesht një grumbull faqesh, por një mik që zgjon ëndrra, ushqen shpirtin dhe i jep krahë për të parë përtej asaj që shohin çdo ditë.

Autorja e dashur për fëmijët surprizë e këndshme për ta

Momenti më i veçantë i ditës ishte prania e autores për fëmijë Adelina Mamaqi, e cila ndau histori dhe emocione me të vegjlit. Zëri i saj, bashkë me buzëqeshjet e fëmijëve, krijoi një atmosferë ku fjala e shkruar merrte jetë dhe ku çdo histori bëhej një dritare e vogël drejt një bote më të madhe.

Një ditë që mbetet

Në fund të fundit, “Fjala që dhuron botë” ishte më shumë se një dhurim librash. Ishte një rikthim tek vetja një kujtim se për fëmijët, dhe për ne të gjithë, leximi mbetet një nga dhuratat më të bukura që mund t’i bësh vetes. Një ditë plot ngrohtësi, buzëqeshje dhe dashuri për fjalën e shkruar.



Përgatiti:

Sibora Këllezi

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit
dhe Arteve Liberale,

Departmenti I Shkencave Humane dhe
Komunikimit me profil Marrëdhënie
Publike

Studente e vitit të tretë

KOM₃₀₁

Klubi i Arteve Vizuale

– Nga Krijimtaria në Angazhim

Pedagoge mentoruese:

Dr. Blegina Hasko Bezo



Puna me Klubin e Arteve Vizuale gjatë këtij viti akademik ka qenë një përvojë që ka tejkaluar pritshmëritë e mia fillestare. Qëllimi im nuk ishte thjesht të krijojmë një grup studentësh të interesuar për artin, por një komunitet aktiv ku krijimtaria të lidhej me përvojën reale, bashkëpunimin dhe angazhimin në jetën universitare e më gjerë.

“Ajo që më ka bërë më shumë përshtypje

ka qenë gatishmëria e studentëve për ta shtrirë procesin e të nxënit përtej auditorit, duke e kthyer artin në një përvojë konkrete bashkëpunimi, krijimi dhe angazhimi.” Përmes projekteve të ndryshme, ata kanë pasur mundësinë të kuptojnë se arti nuk është vetëm rezultat estetik, por proces, përgjegjësi dhe komunikim me publikun.

Një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së klubit ka qenë përfshirja në realizimin e skenografive për shfaqje teatrore, ku studentët kanë bashkëpunuar në krijimin e hapësirave vizuale që mbështesin narrativën skenike.

Veçanërisht e vlefshme ishte eksperiencia e realizimit të skenografisë së shfaqjes “Pulëbardha” me regji të Dritan Boriçit, si dhe kontributi në skenografinë e shfaqjes “Balada e një djali të mirë dhe një djali të keq”, nën drejtimin e Dr. Driada Dervishit. Këto projekte u dhanë studentëve mundësinë të përjetojnë nga afër procesin e punës artistike në kushte reale dhe të kuptojnë rëndësinë e bashkëpunimit ndërdisiplinor.

Po aq domethënës ka qenë edhe angazhimi në aktivitetet e zhvilluara me Shtëpinë e Fëmijës, ku arti u shndërrua në një mjet komunikimi dhe ndarjeje emocionesh me komunitetin. Këto përvoja i ndihmuan studentët të kuptojnë dimensionin social të praktikës

artistike dhe rolin që arti mund të luajë në krijimin e lidhjeve njerëzore.

Një moment i veçantë për klubin ishte aktiviteti i zhvilluar në Spaç në bashkëpunim me Klubin Russell, ku studentët realizuan punime artistike dhe morën pjesë në një dialog mbi kujtesën, dinjitetin dhe historinë. Ky aktivitet dëshmoi se arti mund të jetë një formë reflektimi kritik dhe një mënyrë për të mbajtur gjallë kujtesën kolektive përmes gjuhës vizuale.

Sot mund të them me bindje se Klubi i Arteve Vizuale është kthyer në një hapësirë ku talenti, përkushtimi dhe bashkëpunimi takohen për të krijuar eksperiencë që shkojnë përtej auditorit. Mbi të gjitha, ai ka dëshmuar se arti është më i vlefshëm kur lidhet me njerëzit, me komunitetin dhe me historitë që na bashkojnë.

Përgatitur nga:

Grejsi Xhani

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale,

Departamenti i Arteve të Aplikuara , profil në aktrim.

Studente e vitit të dytë

AS201

Balada

e një djali të mirë
dhe një djali të
keq”:

*Kur Studentët e UET
Vënë në Skënë Moralin*



Kur Mark Twain takon teatrin studentor, lind një baladë që nuk të lë indiferent. “Balada e një djali të mirë dhe një djali të keq” u shfaq në skenën e UET si një projekt i frymëzuar nga dy tregimet ikonike të shkrimtarit amerikan, të dramatizuara me kreativitet nga pedagogia Driada Dervishi. Në qendër të saj, dy jetë, dy zgjedhje dhe një pyetje që vazhdon të rëndojë: çfarë e bën një njeri të mirë apo të keq?



Nga idetë e Twain në skenën shqiptare

Vepra lindi nga dëshira për të krijuar diçka më shumë se një shfaqje teatri. Pedagogia Driada Dervishi mori dy tregimet “Djali i mirë” dhe “Djali i keq” dhe i bashkoi në një baladë skenike të vetme. Në skenë dolën dy personazhe me rrugë të ndryshme jetese, ndërsa një narratori iu bashkua për të shpalosur me finesë kontradiktat morale që ata përjetonin. Ironia e hollë dhe kontrastet e forta mes së mirës dhe së keqes e mbajtën audiencën të fiksuar jo për t’u dhënë një moral të thjeshtë, por për ta bërë të mendojë.

Erdi Mara dhe sfida e të qenit “djali i keq”

Erdi Mara, studenti që dha jetë “djalit të keq”, e pranon se roli ishte një sfidë e madhe personale. “Personazhi im ishte krejt e kundërta e asaj që jam në jetën reale. Më duhej të mendoja negativisht dhe të shihja botën me sytë e tij,” tregon ai. Emocionet para daljes në skenë ishin të forta, por sapo drita u ndez, ndjeu se nuk ishte më Erdi, por vetë personazhi që mishëronte. Për të, qëllimi i shfaqjes nuk ishte të jepte një përfundim të gatshëm, por të nxitte publikun të reflektonte. “Nuk donim që audienca të largohej duke thënë ‘moral i fabulës ishte ky’, por të mendonte më gjatë mbi atë që pa,” shton ai.



Muzika që i jep shpirt veprës

Në skenë nuk ishin vetëm aktorët. Luna Çausholli solli një performancë live me kitarë dhe harmonikë që pasuroi atmosferën artistike. “Ishte hera e parë që performoja me harmonikë në një projekt të tillë dhe ishte një eksperiencë fantastike,” rrëfen ajo. Zgjedhja e harmonikës erdhi spontanisht gjatë provave, por efekti ishte i fuqishëm: emocionet që solli kjo kombinim instrumentesh i dhanë shfaqjes një dimension më të thellë.

Skenografia: Peshoja simbolike mes së mirës dhe së keqes

Prapa skenës, një grup studentësh Erlinda Ahmetaj, Orinda Cami, Jon Kasaruho dhe Emil Nuka punuan për të krijuar ambientin vizual, nën drejtimin e pedagoges Dr. Blegina Bezo. Jon Kasaruho tregon se realizimi zgjati rreth dy javë, ndërsa sfida më e madhe ishte ndërtimi i elementit të peshores, simbol i balancës mes së mirës dhe së keqes. “Punën e nisëm nga skicat për idetë fillestare. Bashkëpunimi në grup ishte shumë i mirë,” thotë ai. Drejtimi i profesoreshës Bezo ndihmoi që skenografia të ruante harmoni me mesazhin e shfaqjes, duke krijuar një ambient dinamik dhe estetikisht të kuruar.



Çfarë na la kjo baladë?

“Balada e një djali të mirë dhe një djali të keq” u shndërrua në një shembull të bukur të bashkëpunimit mes studentëve të degëve të ndryshme të teatrore, muzikë dhe skenografia u ndërthurën për të sjellë një vepër që flet për realitetin tonë. Përmes situatave ironike, ajo prek tema të ndjeshme si korrupsioni, konkurrenca e padrejtë dhe pushteti i njerëzve të pasur mbi ata më të dobët. Por mbi të gjitha, ajo dëshmoi se arti vazhdon të jetë një mënyrë e fuqishme për të ngritur pyetje, për të sfiduar mendimin dhe për të reflektuar mbi botën që na rrethon. Në fund të fundit, çdo shfaqje e mirë nuk të jep përgjigje, të lë me pyetje që vazhdojnë të rëndojnë.

Përgatitur nga:

Sibora Këllezi


Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve
Liberale,

Departmenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit
, profil “Gazetari”

Studente e vitit të tretë

KOM301

“PROPOZIMI I
PULËBARDHËS”:
KUR NJË PROVIM U
SHNDËRRUA NË MAGJI
SKENIKE



Çfarë ndodh kur një provim i thjeshtë aktrimi merr jetë të vetë dhe tejkalon çdo pritshmëri?

Përgjigjja është “Propozimi i Pulëbardhës”, shfaqja e studentëve të UET-së që nisi si detyrë klasë dhe u kthye në një përvojë artistike të vërtetë, duke bashkuar në skenë studentë të vitit të parë dhe të dytë në një atmosferë që kujtonte botën e Çehovit.

Nga provimi në skenë të vërtetë

Gjithçka nisi si një provim i lëndës së aktrimit, por shpejt u bë e qartë se këtu po lindi diçka më e madhe. Duke ndërthurur dy vepra, studentët krijuan një univers të pasur me emocione dhe karaktere që i dha publikut shumë më shumë se një shfaqje të zakonshme. Në qendër të saj qëndronin studentë që nuk luanin thjesht role, por ndërtonin botë të plota.



Dy role, një shpirt

Grejsi Xhani, studente e vitit të dytë, ishte një nga pjesëmarrëset që mori përsipër dy sfida njëkohësisht. Së bashku me Migena Gjylen dhe Elgis Petin, ajo luajti dy personazhe secila Nina dhe Natalia. “Kësaj here procesi i provave ishte më i gjatë dhe më intensiv,” tregon ajo. “Na duhej të ndërtonim nga fillimi dy botë të ndryshme karakteriale.” Pavarësisht se dy personazhet ishin krejt të ndryshëm, Grejsi gjeti në secilin elementë që e lidhnin personalisht me to, duke krijuar një raport emocional që e bëri interpretimin e saj autentik.

Fryma e grupit: Kur të gjithë punojnë si një

Çfarë e bëri këtë shfaqje të veçantë nuk ishin vetëm interpretimet individuale, por bashkëpunimi. Nga studimi i skenarit te provat e fundit e deri te premiera, studentët punuan si një trup i vetëm artistik. Kjo frymë grupi jo vetëm që rriti cilësinë e asaj që u shfaq në skenë, por e bëri çdo takim provash një përvojë të vyer në vetvete. “Nuk ishte thjesht një shfaqje, ishte një mësim mbi punën intensive që kërkon arti,” shprehet Grejsi.

Mësuesit që ndriçuan rrugën

Prapa çdo shfaqjeje të mirë ka njerëz që orientojnë. Profesor Dritan Boriçi, në rolin e pedagogut udhëheqës dhe regjisorit, qe udhërrëfyesi i vazhdueshëm i grupit — duke i këshilluar dhe kritikuar në mënyrë konstruktive në çdo hap. Profesor Kristi Bello dha kontribut të rëndësishëm veçanërisht në formësimin e personazhit të Ninës, e cila kishte një lidhje të fortë me muzikën dhe interpretonte një nga kolonat zanore të shfaqjes. Ndërkohë, profesoresha Blegina Bezo së bashku me dy studentë të arteve pamore punuan për dimensionin vizual, duke sjellë motive çehoviane që plotësuan atmosferën artistike.

Arti që bashkon disiplina

“Propozimi i Pulëbardhës” dëshmoi se kur studentë të aktrimit, regjisë, arteve muzikore dhe atyre pamore punojnë së bashku, lind diçka e plotë në çdo dimension. Ishte një shfaqje që nuk mbërtiste vetëm në fjalë, por në tinguj, ngjyra dhe lëvizje. Për Grejsin, kjo ishte dëshmia më e mirë se bashkëpunimi ndërdisiplinor nuk është thjesht një term i bukur, por një realitet që funksionon.

Drita që mbetet

Në fund të fundit, “Propozimi i Pulëbardhës” ishte më shumë se një natë teatri. Ishte një dëshmi se kur studentët i japin shpirt një ideje, kur mësuesit u besojnë dhe kur disiplina të ndryshme takohen, lind arti i vërtetë. Grejsi shpreson që kjo shfaqje të ketë ndezur një dritë te çdo spektator dhe që kjo dritë të vazhdojë të ndriçojë edhe projekte të tjera bashkëpunuese në të ardhmen

Përgatitur nga:

Sibora Këllezi

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe
Arteve Liberale,

Departmenti i Shkencave Humane dhe
Komunikimit , profil “Gazetari”

Studente e vitit të tretë

KOM₃₀₁

Klubi i Arteve

- Hapësira ku Imagjinata merr Jetë

Pedagogu mentorues:

Dokt. Kristi Bello

Nëse jeta universitare në UET do të ishte një telajo e bardhë, Klubi i Arteve do të ishte pa dyshim peneli që i jep ngjyrat më të gjalla dhe plot dritë. Përtej leksioneve dhe provimeve, ky klub ka qenë dhe mbetet një pike referimi ku nëpërmjet pasionit çdo talent gjen “skenën” e tij.

Për t’i dhënë zë çdo forme të shprehjes krijuese, klubi ynë funksionon i ndarë në tri disiplina: muzikë (kanto dhe instrument), teatër dhe arte pamore. Këto tri shtylla nuk janë thjesht profile akademike, por hapësira ku studentë nga të gjitha programet e studimit bëhen bashkë për të ndarë ide, për të folur për të bukurën dhe për të sfiduar veten.

Duke qenë se arti merr kuptim vetëm atëherë kur ndahet me të tjerët, fryti më i bukur i këtij bashkëpunimi është realizimi i aktiviteteve që i japin gjallëri jetës sonë universitare, koncertet plot energji, shfaqjet e teatrit që përcjellin

emocione të forta dhe ekspozitat ku idetë e studentëve marrin formë dhe ngjyrë. Secili prej këtyre organizimeve është një “masterclass” më vete, ku studentët jo vetëm shfaqin atë që dinë të bëjnë më mirë, por edhe mësojnë e rriten profesionalisht.

Në faqet e kësaj reviste do të gjeni pikërisht këtë puls krijues, një copëz nga atmosfera dhe energjia që studentët krijojnë dhe shfaqin, duke treguar se kjo hapësirë është dëshmia më e qartë se në UET ka vend për të gjithë ata që guxojnë të shprehen përmes artit.

Nëse këndoni, luani në një instrument, aktroni, pikturoni ose thjesht jeni të apasionuar pas skenës, kjo është një ftesë e hapur: Klubi i Arteve ju pret për të shkruar dhe krijuar historitë tona të radhës!

Shijojeni këtë udhëtim dhe lexim të mbarë!

Përgatitur nga:

Grejsi Xhani

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale,

Departamenti i Arteve të Aplikuara , profil “Aktrim” .

Studente e vitit të dytë

AS201

Klubi i Arteve: Teater -Dritan Boriçi



Ka qenë një kënaqësi e jashtëzakonshme. Kam pasur të bëj me vajza dhe djem shumë të talentuar, studentë që punonin orar pa orar, pavarësisht pranisë ose jo të pedagogut. Studentë që i kuptonin shumë shpejt gjithë kritikën dhe përmirësoheshin. Mendoj që deri tani është arritur pjekuria më e madhe që kapatur Klubi i Teatrit në UET pas kaq vitesh, me shfaqjen tejet profesionale që krijuam së bashku.

Përgatitur nga:

Grejsi Xhani

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale,

Departamenti i Arteve të Aplikuara , profil në aktrim.

Studente e vitit të dytë

AS201

Studentët e UET në Burgun e Spacit:

Kur Arti
Takon Historinë

Më 7 Mars, ndërsa të tjerë festonin Ditën e Mësuesit, studentë nga Klubi i Arteve dhe Klubi Russell në UET zgjodhën një rrugë krejt ndryshe. Ata u nisën drejt Burgut të Spaçit një vend që flet ende për një nga periudhat më të vështira të Shqipërisë.



Pse pikërisht atje?

Spaçi nuk është thjesht një ndërtesë e vjetër. Është një vend ku njerëzit humbën lirinë vetëm sepse mendonin ndryshe. Duke ecur mes qelive dhe korridoreve të errët, studentët përjetuan nga afër se çfarë do të thotë të të mohosh lirinë. Heshtja aty brenda flet më shumë se çdo libër historie.

Arti si gjuhë kujtimi

Aktiviteti u organizua nga disa grupe studentore së bashku me pedagogët e tyre. Studentë nga Shkencat Politike, Artet Pamore, Arkitektura, Aktori dhe Kanto u bashkuan për të krijuar diçka unike: interpretuan poezi, kënduan, dhe hapur një ekspozitë me punimet e tyre artistike. Gjithçka ishte fokusuar tek një temë lirinë, dinjitetin njerëzor dhe rëndësinë e kujtesës. U zhvillua edhe një panel me titullin “Dialog mbi shtypjen, dinjitetin dhe kujtesën”, ku u diskutua pse është kaq e rëndësishme të mos harrojmë.

“Kujtesa është detyrë morale”

Një nga momentet më të fuqishme ishte kur pedagogu Kristi Bello u drejtua të pranishmëve. Ai tha: “Në këtë vend, ku dikur tentohej të mbytej mendimi, ne sot ishim me brezin e ri për të dëshmuar se: Kujtesa është detyrë morale. E vërteta nuk mund të mbetet nën rrënoja.”

Kjo e ndryshoi gjithçka. Aktiviteti nuk ishte më vetëm një vizitë apo një shfaqje arti u kthye në një mesazh që brezi i ri nuk do ta lejojë historinë të fshihet.

Çfarë ndjenë studentët?

Shumë prej tyre e përshkruan këtë ditë si “tronditëse” dhe “të rëndë emocionalisht”. Përballja me atë që kishin përjetuar njerëzit aty i bëri të kuptonin se sa të vlefshme janë gjërat që ndonjëherë i marrim si të mirëqena: fjala e lirë, mendimi i lirë, mundësia për të studiuar dhe krijuar pa u frikësuar.



Mesazhi që mbetet

Në fund të ditës, kjo nuk ishte thjesht një vizitë në një burg të vjetër. Ishte një mësim jetësor: e kaluara nuk duhet harruar, sepse sig thotë një fjalë e urtë: “Nëse harrojmë të shkuarën, jemi të destinuar ta përsërisim atë.”



Studentët e UET e dëshmuar se arti dhe kujtesa mund të ecin bashkë dhe se brezi i ri është gati ta mbajë gjallë këtë dëshmi.

Redaktuar nga:

Grejsi Xhani

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale,

Departamenti i Arteve të Aplikuara me profil në aktrim.

Studente e vitit të dytë

AS201

Besian Zogaj

-mentori i Klubit Russel



Unë drejtoj Klubin e Shkencave “Bertrand Russell” i cili përfshin studentët e shkencave politike, marrëdhënieve ndërkombëtare, shkencave humane dhe shkencave juridike, por jo vetëm. Natyrisht, si çdo klub i Universitetit European, është i hapur edhe për studentë të tjerë që kanë interes për temat e ditës, për temat shoqërore që janë objekt diskutimi vazhdimisht, janë objekt shqetësimi vazhdimisht. Ne përpiqemi të identifikojmë këto dhe organizojmë takime periodike me studentët tanë, duke ftuar referues, qoftë brenda vendit, po kur është rasti edhe jashtë vendit. Kemi rekord shumë të mirë. Këtë vit ne nisëm me dy cikle si klub studentor

ku kemi realizuar 5 tema për politikën e brendshme dhe 5 tema për politikën e jashtme. Kryesisht çështjet bazike, duke filluar nga reformat territoriale, kodi zgjedhor si një kod zgjedhor, media dhe komunikim politik, popullkultura, reforma në drejtësi, SPAK-u. Ndërkohë për politikën e jashtme kemi pasur akoma dhe më shumë aktivitet, qoftë për çështjet në Iran, çështjet në OKB-së, reformativat e ngrehinës ndërkombëtare, për shkak të sulmit të Rusisë në Ukrainë. Pra, ne jemi përpjekur pasi janë objekt diskutimi në përditshmërinë tonë dhe në leksikun publik, qoftë në hapësirën mediatike, po qoftë edhe për të interesuarit.

Përveç kësaj, ne organizojmë edhe takimin e shkollës kontekstualiste, i cili është një takim i përmuajshëm në Aula Magna, ku identifikojmë një temë që mund të jetë: drejtësia, shteti, ekzistenca, lumturia, teknologjia, liberalizmi, humanizmi. Të gjitha temat që kanë ndikuar në historinë e zhvillimit të civilizimit tonë dhe autorët kanë lënë zë që janë përpjekur t'i japin zë temave universale që shoqërojnë njeriun që në krye të ekzistencës vetë, si psikologjia, liria, demokracia, drejtësia, teknologjia, frika, ekzistenca, e vërteta. Identifikojë një referues, ftohen studentët për një debat të hapur mbi

temë, ku dhe një student jo shumë me shumë formim mund të përfshihet. Është evidentuar se këto debate shkojnë dhe përtej orarit të planifikuar.

Duhet të them që pjesëmarrja në klub është kënaqshme, edhe pse jeta është më e shpejtë, studentët janë pre e stereotipeve të ndryshme që ndryshojnë çdo ditë, që mund të krijojë edhe një farë konfuzioni. Klubi im ka evidentuar se është aktiv dhe pjesëmarrës, por do të doja që të merrnin dhe drejtimin apo moderimin e temave të klubit studentor.

Në mesazhin e fundit për studentët do të shprehesha se karriera akademike e një studenti është një rrugëtim me shumë përbërës dhe etapa. Shumë e rëndësishme, ashtu si çdo gjë në jetë, që këtij rrugëtimi t'i marrësh sa më shumë dhe ta shijosh sa më shumë, pasi përveçse një moment studimi, është edhe një moment shumë i rëndësishëm në jetë. Dhe po flas edhe për eksperiencën time, pasi një ndër pengjet e mia më të mëdha është që shkonim në shkollë, shkonim në bibliotekë në Romë, rrinim me miq e me shokë, debatonim vazhdimisht, por nuk merrnim gjë nga ajo që na ofronte universiteti që në një farë mënyre përbën atë nuklin, atë

esencën e jetës studentore në takime, forume, debate, ekskursionë apo dhe mes përqafimeve në komunitetin studentor.

Dhe nga këndvështrimi i Universitetit European të Tiranës, ka një qasje unike në hapësirën tonë shqiptare, ku nëpërmjet aktiviteteve gati-gati frenetike të përditshme, studentët mund të mësojnë mbi zhvillimet e fundit në çështjet që shqetësojnë shoqërinë, sfidat që ka shoqëria edhe përtej fushës së studimeve të tyre, dhe ndonjëherë kjo nuk është pak dhe duhet shfrytëzuar sa më shumë, edhe për sa i përket njohjes së çështjeve, por mbi të gjitha edhe njohjes me studentët e tjerë të fakulteteve të tjera, të botëve të tjera.

Si përfundim, i ftoja edhe studentët që bëhen pjesë në grupet studentore, t'i shijojnë ato, të frekuentojnë sa më shumë forume ndërkombëtare, të largohen edhe nga klasa, pasi studenti është individ më i lirë që ka bota, kështu që gjërat e forcuara, gjërat me firma, nuk janë të rekomanduara. Do t'i ftoja edhe studentët që të marrin pjesë, por të marrin pjesë me përkushtimin e tyre, me dëshirën e tyre dhe me përgjegjësinë e tyre.

Përgatitur nga:


Sibora Këllezi

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe
Arteve Liberale,

Departamenti i Shkencave Humane dhe
Komunikimit , profil “Gazetari”

Studente e vitit të tretë

KOM301



Kur Arti Takon Mjekësinë: Një Dialog Përtej Fjalëve.

“Diagnoza: Art – Një
laborator i terapisë së artit
përmes filtrit klinik”

Në ambientet e Universitetit European të Tiranës u realizua ekspozita “Diagnoza: Art – Një laborator i terapisë së artit përmes filtrit klinik”, një aktivitet që solli së bashku artin, shëndetin dhe reflektimin njerëzor në një format të veçantë dhe frymëzues. Ekspozita u organizua në bashkëpunim nga Klubi i Arteve dhe Klubi i Mjekësisë “Hipokrati”, duke dëshmuar se ndërveprimi mes disiplinave të ndryshme akademike mund të krijojë hapësira të reja komunikimi, ndërgjegjësimi dhe shprehjeje.



Në qendër të këtij projekti qëndroi edhe puna krijuese dhe pedagogjike e Dr. Blegina Hasko Bezo me studentët e grupit të Arteve Pamore, të cilët transformuan informacionin shkencor, konceptet klinike dhe përjetimet njerëzore në gjuhë vizuale. Përmes një procesi të strukturuar kërkimor dhe artistik, studentët u udhëzuan të interpretonin tema që lidhen me shëndetin fizik dhe emocional, duke i kthyer të dhënat, simptomat, emocionet dhe reflektimet personale në vepra me forcë të veçantë shprehëse.

Kjo përvojë tregoi se arti mund të shërbejë si një mjet i rëndësishëm për të kuptuar më mirë njeriun, për të nxitur dialogun dhe për të zhvilluar empatinë.

Përmes punimeve artistike, studentët patën mundësinë të

eksploronin temat e shëndetit, përjetimeve emocionale dhe mënyrës se si trupi dhe mendja komunikojnë me njëri-tjetrin. Në aktivitet morën pjesë studentë, pedagogë dhe të ftuar të tjerë, të cilët e përjetuan ekspozitën jo thjesht si një prezantim artistik, por si një ftesë për të reflektuar mbi marrëdhënien tonë me shëndetin. Punimet e ekspozuara përcollën emocione të forta, duke prekur tema që shpesh mbeten të pathëna: frika, dhimbja, pasiguria, por edhe shpresa, kujdesi dhe nevoja për mirëkuptim.



Mesazhi kryesor i kësaj ekspozite ishte i qartë: duhet të jemi më të hapur për të folur për shëndetin tonë, si fizik ashtu edhe emocional. Të flasim me njëri-tjetrin, të ndajmë përjetimet tona dhe të mos e shohim shëndetin vetëm si një çështje individuale, por si një pjesë të rëndësishme të marrëdhënieve njerëzore dhe komunitetit ku bëjmë pjesë.



“Diagnoza: Art” shërbeu si një formë ekspresioni ku arti u kthye në gjuhë komunikimi dhe në një urë mes përjetimit personal dhe kuptimit klinik. Ky aktivitet tregoi se arti mund të jetë një mënyrë e fuqishme për të folur aty ku fjalët mungojnë, për të kuptuar më mirë veten dhe për të ndërtuar më shumë ndjeshmëri ndaj të tjerëve.



Siç thekson Dr. Blegina Hasko Bezo: “Arti është vendi ku ajo që nuk mund të shpjegohet me fjalë, gjen formë, ngjyrë dhe kuptim.” Kjo filozofi u reflektua në çdo vepër të ekspozuar, duke e kthyer ekspozitën në një përvojë që bashkoi dijen, krijimtarinë dhe humanizmin në një dialog të hapur mes artit dhe jetës.



Intervista me Mentorin e Klubit "Hipokrati" -Kristi Çela



Klubi i Hipokratit, i cili përfaqëson studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike në UET, është kthyer në një nga hapësirat më aktive për zhvillimin profesional, social dhe personal të studentëve. Nën drejtimin e mentorit të tij prej tre vitesh, klubi ka ndërtuar një kulturë bashkëpunimi dhe angazhimi që shkon përtej auditorëve universitarë.

Sipas mentorit, filozofia kryesore e klubit është t'i japë studentëve mundësinë të shfaqin potencialin e tyre jashtë sallës së leksionit. Ai e sheh veten më shumë si një lehtësues sesa si drejtues, duke inkurajuar studentët të marrin iniciativa dhe të udhëheqin vetë aktivitetet që organizohen.

Gjatë viteve të fundit, Klubi i Hipokratit ka organizuar një sërë aktivitetesh me fokus promovimin e shëndetit në komunitet.

Aktivitetet kanë trajtuar tema të rëndësishme si sindroma Down, kanceri i gjirit dhe edukimi seksual. Një nga nismat më të spikatura ka qenë fushata e Tetorit Rozë, ku studentët kanë shpërndarë materiale informuese dhe kanë ndërgjegjësuar qytetarët në qendër të qytetit për rëndësinë e diagnostikimit të hershëm të kancerit të gjirit.

Përveç aktiviteteve sensibilizuese, klubi i kushton rëndësi edhe zhvillimit kulturor dhe social të studentëve. Nën moton “Health for All” (Shëndeti për të Gjithë), anëtarët kanë bashkëpunuar me klube të tjera studentore të universitetit, si Klubi i Psikologjisë dhe Klubi i Arteve, duke organizuar aktivitete të përbashkëta dhe projekte ndërdisiplinore.

Në axhendën e klubit kanë gjetur vend edhe aktivitete më argëtuese dhe sociale, si analizat e filmave me tematikë mjekësore, diskutimet mbi libra, si dhe ecjet në natyrë (hiking), të cilat sipas mentorit kanë qenë ndër aktivitetet më të suksesshme për krijimin e lidhjeve mes studentëve.

Megjithatë, një nga sfidat kryesore mbetet angazhimi i vazhdueshëm i studentëve. Edhe pse klubi numëron mbi 50 anëtarë, vetëm një pjesë e tyre marrin pjesë rregullisht në aktivitetet e organizuara. Ngarkesa akademike, turpi apo vështirësia për t'u integruar me studentë nga vite të ndryshme studimi janë disa nga arsyet që ndikojnë në këtë situatë.

Për të motivuar studentët, mentori përpiqet të krijojë një atmosferë sa më miqësore dhe joformale, ku marrëdhëniet të mos kufizohen vetëm në raportin pedagog-student. Përmes komunikimit të vazhdueshëm dhe aktiviteteve sociale, ai synon t'u tregojë studentëve se pjesëmarrja në klub nuk është vetëm një eksperiencë argëtuese, por edhe një mundësi për të zhvilluar aftësi të rëndësishme personale dhe profesionale, të njohura si “soft skills”.

Klubi i Hipokratit vazhdon të mbetet një shembull i rëndësishëm i angazhimit studentor në UET, duke dëshmuar se edukimi nuk zhvillohet vetëm në auditor, por edhe përmes aktiviteteve që nxisin bashkëpunimin, përgjegjësinë sociale dhe zhvillimin e aftësive jetësor

Përgatitur nga:

Irini Tollumi,

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale,

Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit , profil “Marketing”

Studente e vitit të dytë

KOM201

Klubi i Letërsisë: Kadare -Ermir Nika



Klubi Kadare ka një emër të madh dhe normalisht pretendimi për ta mbajtur lart, për të mbajtur edhe frymën, për të mbajtur nënjë farë mënyre edhe komunitetin e studentëve që lexojnë dhe janë të interesuar për librin, është një nga objektivat kryesore.

Unë shikoj që te klubi të paktën kemi arritur një lloj bashkëpunimi, një lloj fryme. Ky lloj klubi do të ketë frymë, prajo thjeshte të jetë një bashkësi.

Aty do të jemi të gjithë të barabartë, të lexojmë dhe të shkëmbejmë mendime, emocione, pikëpamje mbi libra të ndryshëm. Janë librat ata që pastaj konfigurohen në skenë, ekran, sepse nga libri lind gjithçka. Lind skenari, dramaturgjia.

Kultura e shkruar është arti kryesor, pastaj ajo fillon dhe transformohet në arte të tjera. Unë mendoj që Klubi i Librit Kadare ka një mision të madh, sepse nuk është vetëm për të mbajtur emrin dhe për ta përfaqësuar atë, por edhe për të zgjeruar komunitetin e studentëve me marrëdhënien e tyre me librin dhe me dijen. Nuk mund të ketë universitet që nuk ka në themel të tij librin, dijen.

Prandaj unë i vë theksin se është një nga klubet më të rëndësishme, që ka bërë aktivitete, ka bërë shfaqje, performanca poetike shumë të mira. Ka krijuar deri te një film me poezitë e Preç Zogajt, që e kemi realizuar me shumë sukses vjet, dhe këtëvit përsëri vumë në skenë veprën e Kadaresë në Teatrin e Operës.

Mendoj që është një klub që lë një nostalgji pas, sepse aty zhvillohet pasioni dhe lihet një gjurmë në formimin e gjithësekujt.

Përgatitur nga:

Grejsi Xhani

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe
Arteve Liberale,

Departamenti i Arteve te Aplikuara,
profi”Aktrim”.

Studente e vitit të dytë

AS201

Fjalët e mentores së Klubit “John Locke” -Dr. Sofjana Veliut



Të gjitha aktivitetet që janë ndërmarrë kanë pasur qëllim jo vetëm aktivizimin e studentëve dhe mënyrën se si aktivitetet trajtohen brenda departamentit dhe fakultetit, por kanë pasur si qëllim edhe interaktivitetin me organet e drejtësisë dhe jo vetëm. Në lidhje me klubin, synimi i klubit janë të gjitha hulumtimet, komentet e ligjeve, rregulloret mbi legjislacionin e propozuar dhe çështjet që mund të trajtohen brenda

institucioneve si gjykatat dhe institucionet e vuajtjes së dënimit. Qëllimi i klubit është edhe promovimi i punëve të studentëve duke organizuar tryezat e rrumbullakëta, seminare, konferenca, gjyqe simuluese, por edhe studentët të jenë vizitorë më pranë institucioneve që të bëjnë më shpejt lidhjen dhe integrimin në tregun e punës, që kjo të mos jetë pastaj një surprizë, por gradualisht në 5 vjet, ashtu siç e përcakton dhe “Ligji për Arsimin e Lartë”, për sa i përket diplomës së programit të integruar drejtësi të kenë një lloj periodizimi që studentët të jenë sa më afër tregut të punës brenda programeve të tyre të studimit. Klubi “John Locke” në një hark kohor që shpeshherë dinamika e vizitave, seminareve mund të mos jetë e shpejt dhe e shpeshtë, ne jemi mundësuar të kemi një lloj dinamike koherente me kalendarin akademik, pasi studentët kanë pushim dhe provime dhe ndoshta nuk mund të angazhohen dot. Ne duam që këto takime të bëjnë sens dhe të tërheqin vëmendjen e studentëve, pra të mos bëhen monotone dhe të mos dalin jashtë fokusit. Kështu që jemi përpjekur në bashkëpunim me anëtarët e stafit akademik, me pedagogët dhe kolegët tanë që studentët të ndjekin një seri vizitash në institucione siç janë gjykatat qofshin këto gjykatat e

juridiksionit të përgjithshëm të dhomës penale dhe dhomës civile dhe vizitat që mund të kemi pasur në gjykatën e apelit. Interesante kanë qenë edhe vizitat që janë bërë në institucionin e vuajtjes së dënimit në Burgun e Grave ku përgjegjësi i departamentit me një numër studentësh kanë qenë prezent atje.

Mjaft interesante ka qenë edhe pjesëmarrja në konkursin kombëtar dhe ndërkombëtar që u organizua nga studio Halimi në bashkëpunim me Ambasadën Holandeze, ne kishim pjesëmarrjen e 3 studentëve të vitit të tretë: Greis Kanani, Orgita Gjoka dhe Relva Haxhiu të cilat na nderuan sepse jo vetëm që fituan çmimin e parë dhe dolën skuadra më e mirë, por Orgita gjithashtu fitoi edhe çmimin si “Relatorja më e mirë” e këtij konkursi. Ne mezi presim që ta finalizojmë këtë proces, me marrjen pjesë si ekip fitues dhe si institucion në konferencën e ndarjes së çmimeve pasi ndihemi krenar për studentet tona. Përveç kësaj, ajo çka është interesante është se studentëve do t’u ofrohet si skuadër fituese një vizitë studimore në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasbourg, çka do të kurorëzojë një punë intensive dhe me shumë emocion. Megjithatë, përsëri ne nuk kemi lënë që të dalim vetëm jashtë institucionit,

por ne si departament bashkëpunojmë me institucionet e drejtësisë duke i ftuar ata të vijnë këtu. Është prezantuar një projekt shumë i mirë “Drejtësia për Ju” platforma e cila u paraqit nga një ish-studentë e UET, alumni “Enxhi Hoxha”. Ajo paraqiti përpara studentëve platformën e saj se si mund të ndihmojë për të aksesuar dhe për të marrë konsulencë juridike nëpërmjet platformës “Drejtësia për Ju.” Pati një angazhim goxha të madh nga studentët të cilët morën një informacion të mjaftueshëm në lidhje me këtë pjesë, patjetër që institucioni do të kryejë dhe marrëveshjen e bashkëpunimit me platformën dhe me studion ligjore të Enxhit. Janë bërë vizita në SPAK nga studentët e vitit të katërt shoqëruar nga pedagogët përkatës që ndjekin lëndët “procedurë civile” dhe “procedurë penale”. Kemi pasur të ftuar le të themi special si gjyqtarë të Gjykatës së Posaçme, gjyqtarë të nivelit të lartë përderisa kanë një reputacion shumë të mirë në sistemin e drejtësisë si Rudina Palloj, ka qenë e ftuar në një bashkëbisedim të lirshëm me studentët, përveçse iu drejtua auditorit në një mënyrë të lirshme, ajo i paraqiti studentëve punën e saj, momentet më të vështira dhe më të bukura nga eksperiencia e saj si gjyqtare dhe patjetër që ngjalli kërshëri për të gjithë studentët që

le të themi në përfundim të studimeve duan të ndjekin rrugën e magjistratit qoftë kjo në cilësinë e gjyqtarit ose prokurorit. Pritet që të kemi të ftuar edhe një gjyqtare nga Gjykata e Apelit ku pritet të diskutohet në lidhje me çështjet që reforma në drejtësi ka spikatur kohët e fundit, por edhe angazhimet që një gjyqtar mund të japë në kuadër të kësaj reforme dhe sa e vështirë është të shqyrtojë çështje të ndryshme, kur vetë reforma në drejtësi ka shumë dilema dhe polemika. Patjetër ne deri në fund të qershorit me finalizimin e këtij viti akademik, ne kemi edhe disa takime për të përmbyllur, ajo çka është më e rëndësishme është që të gjitha klubet do të finalizojnë një revistë, e cila është risi në UET në të cilën do të përmbledhen të gjitha aktivitetet e bëra gjatë këtij viti qofshin këto vizita apo takime, të cilat mos të ngelin vetëm të dokumentuara, por të marrin jetë nëpërmjet ilustrimit të një reviste.

Përgatitur nga:

Greis Kanani

Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Departamenti i Juridikut, profi "Drejtësi".

Studente e vitit të tretë

J301



Aktivitet “Ditët e Hapura” në Gjykatën Kushtetuese

Nga Mentorja e Klubit
“John Locke” Sofjana Veliu

Vizita e studentëve të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit European të Tiranës (UET) në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë u zhvillua në kuadër të aktiviteteve të “Ditëve të Hapura”, me qëllim afrimin e studentëve me funksionimin praktik të drejtësisë kushtetuese. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin studentët e vitit 1,2,3 DIND Drejtësi, të cilët u njohën me rolin dhe rëndësinë e Gjykatës Kushtetuese në sistemin juridik shqiptar nëpërmjet një lidhje direkte mes teorisë së mësuar në auditor dhe praktikës institucionale.



Studentët patën mundësinë të bashkëbisedonin me, gjyqtaret Sonila Bejtja dhe Marjana Semini, si dhe me këshilltaret ligjore Ela Elezi, dhe Kaliona Nushi. Gjatë diskutimeve, u ndalën në çështje konkrete të praktikës së Gjykatës, duke sjellë një qasje më të drejtpërdrejtë mbi funksionimin e drejtësisë kushtetuese.

Studentet tona të vitit të 3 Dind , Greis Kanani dhe Aulona Balliu drejtuan pyetje drejt panelit në lidhje me “presionin” që mund të ketë GJK në lidhje me vendimmarrjen e saj dhe sa e ndikuar ndihet ajo në këtë vendimmarrje. Ndërsa studentja e vitit 1 Dind, Sofia Muco duke shprehur dëshirën që ne të ardhmen të vazhdojë studimet në Shkollën e Magjistraturës, shtroi pyetjen se cilat mund të jenë sfidat për të qenë një gjyqtare e mirë.



Më pas studentët vizituan mjediset e institucionit, dhe nëpërmjet ekspozimit të disa dokumentave, buletinit të vendimeve dhe një dokumentari të shkurtër u njohën me historikun e Gjykatës Kushtetuese ndër vite. Studentëve iu kërkuar që në mënyrë sfiduese, të sillnin ide të reja /slogane në kuadër të edukimit ligjor dhe misionit që ka Gjykata Kushtetuese dhe sesi shihet ajo në sytë e studentëve të drejtësisë. Në fund të takimit studentët bënë foto me Kryetaren e GJK dhe Gjyqtaret e pranishme në këtë takim, duke ruajtur mbresa të vecanta nga ky aktivitet dhe duke shpresuar që të tilla organizime duhet të jenë më të shpeshta.

Klubi i inxhinierisë “Nikola Tesla” Pedagogu Mentorues: **Jani Petro**



Klubi i Inxhinierisë “Nikola Tesla” është një hapësirë akademike dhe profesionale që bashkon studentët e apasionuar pas teknologjisë, inovacionit dhe zgjidhjes së problemeve reale përmes inxhinierisë. Edhe pse fokusi kryesor i klubit është inxhinieria mekanike, ai mirëpret studentë nga të gjitha degët e inxhinierisë, përfshirë inxhinierinë elektrike, elektronike, informatike, mekatronike dhe fusha të tjera të lidhura me teknologjinë.

Qëllimi kryesor i klubit është të krijojë një urë lidhëse midis njohurive teorike të marra në auditor dhe aplikimit të tyre në projekte konkrete, duke nxitur kreativitetin, bashkëpunimin dhe mendimin inovativ.

Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, studentët do të kenë mundësinë të zhvillojnë projekte praktike, të marrin pjesë në konkurse teknologjike, të organizojnë vizita studimore, seminare, workshope dhe takime me profesionistë të industrisë.

Një nga synimet afatgjata të klubit është krijimi i ekipeve studentore që do të zhvillojnë projekte inovative në fusha si robotika, automatizimi industrial, dronët, inteligjenca artificiale, energjia e rinovueshme, automjetet inteligjente dhe teknologjitë e së ardhmes. Klubi synon të shndërrohet në një laborator idesh ku studentët të kenë mundësinë të eksperimentojnë, të krijojnë prototipe dhe të zhvillojnë zgjidhje që adresojnë sfida reale të industrisë dhe shoqërisë.

Përmes këtij klubi, studentët do të përfitojnë jo vetëm njohuri teknike shtesë, por edhe aftësi të rëndësishme profesionale si puna në grup, menaxhimi i projekteve, leadershipi, komunikimi teknik dhe prezantimi i ideve

inovative. Klubi “Nikola Tesla” synon të krijojë një komunitet studentësh që jo vetëm mësojnë teknologjinë, por edhe e ndërtojnë atë.

INTERVISTA

1. Pse lindi nevoja për krijimin e Klubit të Inxhinierisë “Nikola Tesla”?

Inxhinieria është një fushë ku teoria dhe praktika duhet të ecin paralelisht. Gjatë viteve kemi vënë re se studentët kanë shumë ide, kreativitet dhe dëshirë për të eksperimentuar, por shpesh u mungon një hapësirë e dedikuar ku këto ide të marrin formë. Pikërisht për këtë arsye lindi nevoja për krijimin e Klubit të Inxhinierisë “Nikola Tesla”.

Klubi synon të krijojë një mjedis ku studentët mund të bashkëpunojnë përtej auditorit, të

zhvillojnë projekte praktike, të njihen me teknologjitë më të fundit dhe të krijojnë kontakte me industrinë. Emri “Nikola Tesla” është zgjedhur jo rastësisht, pasi ai simbolizon inovacionin, kërkimin shkencor dhe guximin për të transformuar idetë në zgjidhje që ndryshojnë botën.

2. Cilat janë objektivat tuaja si pedagog mentorues?

Objektivi im kryesor është që klubi të bëhet një qendër aktive e inovacionit dhe krijimtarisë teknologjike në UET. Synoj të krijoj mundësi që studentët të punojnë në projekte reale, të mësojnë përmes praktikës dhe të zhvillojnë aftësi që kërkohen nga tregu modern i punës.

Në vitet e ardhshme dëshirojmë të ndërtojmë ekipe studentore që të merren me robotikë, dronë, automatizim industrial, sisteme inteligjente, energji të rinovueshme dhe aplikime të inteligjencës artificiale.

Gjithashtu synojmë të organizojmë konkurse teknologjike, vizita në industri, seminare me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë, si dhe bashkëpunime me kompani dhe institucione që operojnë në sektorin e inxhinierisë.

3. Çfarë u premtan ky klub studentëve?

Ky klub u premtton studentëve një përvojë që shkon përtej procesit tradicional të të mësuarit. Ata do të kenë mundësinë të punojnë në projekte konkrete, të zhvillojnë aftësi praktike dhe të ndërtojnë një portofol profesional që do t'i ndihmojë në karrierën e tyre të ardhshme.

Studentët do të kenë mundësi të eksperimentojnë me teknologji moderne, të marrin pjesë në iniciativa inovative dhe të bëhen pjesë e një komuniteti që ndan të njëjtin pasion për teknologjinë dhe zhvillimin. Mbi të gjitha, klubi do t'u japë mundësinë të shohin se si një ide mund të transformohet në një projekt real dhe potencialisht në një produkt me ndikim në shoqëri.

4. Si ka qenë qasja e studentëve ndaj klubit deri më tani?

Edhe pse klubi është hapur vetëm këtë semestër, interesi i studentëve ka qenë shumë pozitiv. Kemi vënë re një entuziazëm të madh, veçanërisht nga studentët që dëshirojnë të përfshihen në aktivitete praktike dhe projekte teknologjike.

Studentët kanë shprehur gatishmëri për të kontribuar me ide të reja dhe kanë treguar

interes për tema si robotika, dronët, automatizimi, energjia dhe teknologjitë inteligjente. Kjo na motivon edhe më shumë për të ndërtuar një klub dinamik, ku secili student të ketë mundësinë të kontribuojë dhe të zhvillohet profesionalisht. Besoj se ky është vetëm fillimi i një komuniteti që do të sjellë projekte interesante dhe rezultate konkrete për universitetin dhe më gjerë

Përgatitur nga:

Grejsi Xhani

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale

Departamenti i Arteve Skenike,
profil "Aktrim".

Studente e vitit të dytë

AS201

Fjalët e mentorit të klubit të sportit “Uet Sport Club” Dr. Marjo Shabanaj



Pjesëmarrja në aktivitete këtë vit në klubin e sportit ka qenë më e madhe se në çdo vit tjetër, me rreth 140 studentë të regjistruar. Ka pasur një mori aktivitetesth, ne jemi të federuar në Federatën e Sportit Universitar ku marrim pjesë në një shumëllojshmëri aktivitetesth si: football, mini football, futsal meshkuj dhe femra, basketball meshkuj dhe femra, volleyball meshkuj dhe femra. Aktualisht, jemi duke marrë pjesë në kupën

studentore universitare të volleyballit të meshkujve. Përpara 1 muaji kemi marrë pjesë në kupën studentore universitare shqiptare futsal për meshkujt, volleyball meshkuj dhe volleyball femra. Për këtë vit akademik, arritja më e madhe që kemi patur është vendi i tretë në kampionatin universitar të futsal të meshkujve, prisnim që të dilnim kampion, por nuk ja dolëm dot, gjithsesi dhe vendi i tretë është i kënaqshëm. Jemi goxha konkurues në sportet universitare, presim që në këtë muaj të zhvillojmë një kampionat universitar të UET-it, besoj në lojën e volleyballit ose pingpongut, miks: meshkuj dhe femra siç e kemi traditë ta bëjmë çdo vit. Bashkëpunimi midis studentëve ka qenë i mirë përgjatë këtij procesi, nuk do ta cilësoja si shumë të mirë pasi ka gjithmonë vend për përmirësim. Ka studentë të cilët janë të gatshëm dhe marrin pjesë në çdo aktivitet dhe në të gjitha lojërat sportive qoftë brenda UET-it, qoftë jashtë UET-it, bashkëpunimi është i mirë, por pres që të jetë edhe më i mirë mbase me përmirësimin e promovimit të aktiviteteve të klubit dhe me një pjesëmarrje më të gjerë të studentëve në aktivitetet që organizon departamenti ose fakulteti.

Një nismë tjetër e rëndësishme që kam marrë

ka qenë dhe formimi i ekipit të futbollit të UET-it përpara 2 vitesh në bashkëpunim me stafin akademik dhe administrativ dhe me studentët. Ne kemi marrë pjesë në Ligën Amatore të Futbollit e cila mbahet nga Federata Kombëtare e Sportit, ku kemi dalë kampion e cila ishte një arritje e madhe për ne. Në vijim, është hapur edhe ekipi profesionist i football-it duke marrë pjesë në kategorinë e tretë. Për momentin ka pasur një shkëputje në vazhdimësinë e kësaj skuadre, por planifikojmë që vitin tjetër akademik, jo këtë vit ta krijojmë sërish këtë nismë, sepse është një promovim shumë i mirë dhe një reklamë shumë e mirë për universitetin dhe sjell goxha studentë të sporteve, dhe jo vetëm. Veçanti tek klubi i sportit është se, pjesa më e madhe e studentëve që janë anëtarë të klubit nuk janë vetëm studentë të sporteve, pasi gati 70% e anëtarëve të klubit të sportit janë nga fakultete të tjera.

Këtë vit organizohet dhe “Kampionati Evropian Universitar i Sporteve Luftarakë” i cili do të zhvillohet në Tiranë, në të cilin UET do të përfaqësohet me një student në fushën e arteve marciale dhe kjo është një arritje tjetër e vyer për studentët tanë.

Përgatitur nga:

Greis Kanani

Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe
Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Departamenti i Juridikut, profi”Drejtësi”.

Studente e vitit të tretë

J301

Fjalët e mentores së Klubit të Inovacionit “Steve Jobs” Dr. Malvina Niklekaj



**Një vit i mbushur me
teknologji kreativitet dhe sfida**

Në fillim të vitit akademik 2025–2026, gjatë takimit të parë të Klubit të Inovacionit “Steve Jobs”, studentët plotësuan një formular të strukturuar, i cili përfshinte fusha të ndryshme të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICT), si dhe preferencat e tyre për aktivitetet që dëshironin të zhvilloheshin përgjatë vitit. Bazuar në analizën e këtyre të dhënave, u hartua një plan aktivitetesh i orientuar drejt interesave dhe nevojave reale të studentëve. Një nga aktivitetet më të rëndësishme ka qenë vizita studimore pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), ku studentët patën mundësinë të njihen nga afër me laboratorët dhe praktikát reale të menaxhimit të incidenteve kibernetike. Kjo eksperiencë u reflektua më tej në zhvillimin e një ore të hapur nga Drejtoresha e SOC dhe CIRT, me temën “Një klik larg kaosit”, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet praktikës institucionale dhe trajtimit akademik të sigurisë kibernetike.

Në vijim, hackathoni “Hack the Network” u organizua si një aktivitet i strukturuar në dy faza, me kohëzgjatje të përcaktuar për secilën, ku studentët u përballën me sfida reale dhe skenarë praktikë, duke u

përgatiturnjëkohësisht për pjesëmarrje në maratona dhe gara të tjera në fushën e sigurisë kibernetike. Gjithashtu, konkursi “Small Assignment, Big Impact” u zhvillua si një platformë konkurruese për studentët e të tre viteve Bachelor, ku ata prezantuan detyra kursi individuale ose ndërdisiplinore, me fokus në inovacionndhe aplikueshmëri në tregun e punës.Paralelisht, studentët e klubit kanë qenë aktivë në pjesëmarrje në konferenca studentore dhe evente akademike si LeapIN Albania dhe DreamIN Albania 2026, si dhe në hackathon-e ndërkombëtare, përfshirë Datathon-in e 8-të Virtual nga Novartis, duke përfaqësuar universitetin në një nivel konkurrues dhe profesional. Arritjet kryesore të Klubit të Inovacionit “Steve Jobs” lidhen me krijimin e një modeli të integruar që ndërthurpërgatitjen akademike me përvojën praktike dhe ekspozimin profesional të studentëve. Një ndër arritjet më të rëndësishme ka qenë përfshirja aktive e studentëve në të gjitha fazat e zhvillimit të aktiviteteve, duke filluar nga planifikimi dhe deri tek realizimi i tyre.

Një element kyç i suksesit ka qenë lidhja e drejtpërdrejtë me institucionet e industrisë, si Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, si dhe integrimi i përvojave

praktike në aktivitetet akademike përmes vizitave studimore dhe leksioneve të hapura. Po ashtu, organizimi i hackathon-eve dhe konkurseve studentore ka kontribuar në zhvillimin e aftësive praktike dhe inovative të studentëve, duke i përgatitur ata për sfida reale dhe për pjesëmarrje në iniciativa kombëtare dhe ndërkombëtare. Një arritje e veçantë ka qenë performanca e studentëve në aktivitete ndërkombëtare si Datathoni i 8-të Virtual nga Novartis, ku dy grupe përfaqësuese të klubit arritën të renditen përkatësisht në vendin e 6-të dhe të 15-të nga rreth 150 grupe pjesëmarrëse. Këto rezultate dëshmojnë nivelin konkurrues dhe përgatitjen e studentëve në një kontekst global. Gjithashtu, pjesëmarrja në konferenca studentore si LeapIN dhe DreamIN Albania 2026 ka kontribuar në rritjen e ekspozimit akademik dhe ndërtimin e rrjeteve profesionale për studentët. Bashkëpunimi midis drejtimit të klubit dhe studentëve është karakterizuar nga një qasje gjithëpërfshirëse dhe dinamike, ku studentët kanë qenë të përfshirë që në fazën fillestare përmes identifikimit të interesave dhe prioriteteve të tyre. Ky bashkëpunim është reflektuar në angazhimin aktiv të studentëve në aktivitete të ndryshme, duke

përfshirë organizimin e hackathon-eve, pjesëmarrjen në konkurse, përfaqësimin në gara ndërkombëtare dhe përgatitjen për konferenca studentore. Përmes këtyre proceseve, studentët kanë zhvilluar jo vetëmaftësi teknike, por edhe kompetenca në punë në grup, menaxhim kohe dhe prezantim profesional.

Si rezultat, është krijuar një ambient bashkëpunues dhe motivues, ku studentët ndihen pjesë aktive e komunitetit akademik dhe kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe suksesin e aktiviteteve të klubit.

Përgatitur nga:


Greis Kanani

Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Departamenti i Juridikut, profi”Drejtësi”.

Studente e vitit të tretë

J301



Workshop

*Kur Materiálet e
Tietra Gjéine
të Re*

Në një kohë kur mjedisi ka nevojë për zgjidhje kreative, studentët e UET treguan se arti mund të jetë një prej tyre. Workshop-i “Upcycling: Kreativitet, qëndrueshmëri dhe art në veprim” bashkoi studentë të Arteve të Aplikuara dhe Arkitekturës për të kthyer materialet e harruara në produkte me vlerë, në bashkëpunim me Agjencinë e Industrisë Kreative.



Çfarë është upcycling, në të vërtetë?

Në dukje ngjan me riciklimin, por është krejt ndryshe. Ndërsa riciklimi fokusohet tek vlera e materialeve, upcycling-i transformon objektet e përdorura drejtpërdrejt në diçka të re, funksionale dhe estetike. Siç e shpjegoi pedagogu Albjon Lushi, kur një produkt modifikohet nga vetë krijuesi, ai fiton identitet të ri dhe vlerë personale. Kështu, pluhuri që mbulon një objekt të vjetër nuk është fundi, por fillimi i një ideje.

Kur dy botë krijuese bashkohen

Bashkëpunimi mes studentëve të Arteve të Aplikuara dhe atyre të Arkitekturës ishte një nga pikat më të forta. Me metoda të ndryshme pune, por me të njëjtin kreativitet, ata krijuan një mjedis ku ide të ndryshme u shndërruan në një projekt të përbashkët. Dr. Blegina Bezo Hasko theksoi se dizajni bashkëkohor nuk krijon thjesht objekte të reja, por i jep kuptim të ri atyre që ekzistojnë tashmë.



Procesi i hapët, jo vetëm rezultati

Çfarë e bëri këtë workshop të veçantë ishte se vizitorët mund të ndiqnin punën e studentëve në kohë reale nga ideja deri te produkti final. Kjo krijoi dialog të drejtpërdrejtë rreth konsumit të përgjegjshëm dhe tregoi se kreativiteti nuk ndodh në fshehtësi, por në bashkëbisedim.

Më shumë se një punë dore

Produktet e realizuara ishin funksionale dhe mbanin identitetin e krijuesit. Por fitimi më i madh ishte tek vetë studentët: ata zhvilluan aftësi në promovimin e ideve, menaxhimin e procesit të punës dhe komunikimin mjete strategjike për çdo karrierë në art, dizajn apo arkitekturë. Workshop-i dëshmoi se kur kreativiteti takohet me qëndrueshmërinë, lindin jo vetëm objekte të bukura, por edhe një mendësi e re për të shikuar mbetjet si mundësi.

Përgatitur nga:

Irini Tollumi,

Fakulteti i Shkencave Humane,

Edukimit dhe Arteve Liberale,

Departamenti i Shkencave

Humane dhe Komunikimit,

profil “Marketing”

Studente e vitit të dytë

KOM201

Fjalët e mentores së Klubit të Arkitekturës dhe Dizajnit “Le Corbusier” Dr.Enkeleida Prifti



Studentë të apasionuar pas artit të arkitekturës, arteve pamore, filozofisë edhe estetikës të së bukurës, janë mbledhur në klubin e Arkitekturës dhe Dizajnit që mban emrin e arkitektit të famshëm “Le Corbusier”. Ata shprehen me gjuhën e artit dhe kanë në fokus organizimin e aktiviteteve në nivel klubi edhe më gjerë, duke arritur kështu edhe tek studentët e tjerë. Antarët e klubit janë studentë të cilët i bashkojnë idetë dhe interesat e tyre të përbashkëta për të eksploruar tematika të reja.

Me krijimtarinë e tyre edhe organizimin e ekspozitave dhe shfaqjeve artistike, synojnë të arrijnë bukur tek artdashësit, me mesazhe kuptimplote për komunitetin dhe më gjerë. Në planin e gjerë të organizimit të Klubit – do të synojë që ti bashkojë studentët e fushës së ngjashme, dhe qëllimi tjetër i rëndësishëm – është që t'i shtojë ngjyra të reja jetës studentore. Në përputhje me drejtimin që ka Klubi i Arkitekturës do të organizohen aktivitete, mbledhje, takime e trajnime të karakterit mësimor, që lejojnë formimin e drejtë shqisor, dhe zhvillimin konjuktiv dhe psikomotor.

Për tu bërë anëtar i klubit mjafton të jesh student i Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit. Aktivitetet dhe takimet : kanë synim të krijojnë kontakte të studentëve me burimet e informacionit për fushën e arkitekturës dhe ndërtimit; si psh. vizita në institucione kryesore si Arkivi i Ndërtimit, ku do të njihen me menyrën e përdorimit të materialeve, dhe metodën e kërkimit të informacionit për tema konkrete të fushës; njohja me organizma rregullatore të të gjithë procesit të organizmit të punëve ndërtimore në vend – p.sh Shoqata e Arkitekteve, e Inxhinierëve Konsulentë,

e Ndërtuesve; deri edhe vizita në studio projektimi të mjeshtreve të arkitekturës për të parë nga afër procesin e projektimit. Do të programohen disa takime me disa prej arkitektëve dhe inxhinierëve të përgatitur të vëndit.

Eskursione: Janë zhvilluar brenda Tiranës dhe jashtë saj në disa prej qyteteve kryesore të vëndit, për të vëzhguar nga afër metodat e ndërtimit dhe stilet e arkitekturës të përdorura në territorin Shqiptar në periudha të ndryshme historike.

Të gjitha këto së bashku do të ndihmojnë në zhvillimin e metodës kërkimore tek studentët dhe deri në nxjerrjen e një produkti final (ekspozita; botim apo shfaqje arti kontemporan).

19 Mars 2026: Klubi studentor Le Corbusier – Arkitekturë & Dizajn në UET organizoi një leksion të hapur me temë “Kurimi i Artit Pamor, Sfida e Artistit”, me të ftuar special artisten Suzana Varvarica Kuka. Studentët e UET patën mundësinë të ndjekin një leksion të hapur mbi kurimin e artit pamor, një eksperiencë që pasuroi perspektivën mbi rolin e artistit dhe

kuratorit sot. Të ftuar edhe artistë pamore si: Azem Kuçana, përfaqësues të drejtuesve të Galerisë Kombëtare të Arteve, etj, e kthyen këtë aktivitet në një forum interesant mbi debatet e kurimit bashkohor edhe sfidave të kohës. Ndërlidhja mes artistit dhe arkitektit si exhibit-designer e bën këtë leksion ekstra-kurikular edhe më të rëndësishëm për antarët e Klubit.

Përgatitur nga:

Greis Kanani

Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Departamenti i Juridikut, profil "Drejtësi".

Studente e vitit të tretë

J301

Fjalët e mentores së Klubit të Financës “Adam Smith” Dr. Grisejda Myslymi



**Nga Auditori në Praktikë: Një
Vit Aktiv me Klubin Studentor
“Adam Smith”**

Gjatë vitit akademik 2025–2026, Klubi Studentor “Adam Smith”, pranë Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës në Universiteti European i Tiranës, zhvilloi një seri aktivitetesth akademike, profesionale dhe kulturore, duke krijuar mundësi të vlefshme për studentët për të lidhur teorinë me praktikën dhe për të zgjeruar horizontin e tyre profesional.

Rrugëtimi i klubit nisi me një takim prezantues në ambientet e UET-it, ku studentët u njohën me misionin dhe objektivat e klubit, si dhe me aktivitetet e planifikuara përgjatë vitit. Që në këtë takim u vu re interesi i studentëve për përfshirje aktive në diskutime, trajnime dhe vizita studimore.

Një nga aktivitetet më të rëndësishme ishte vizita studimore në kompaninë TOK, ku studentët patën mundësinë të njiheshin nga afër me praktikat reale të biznesit, menaxhimit dhe marketingut. Përmes bashkëbisedimeve me profesionistë, ata kuptuan më mirë sfidat dhe dinamikat e tregut të punës.

Klubi organizoi gjithashtu një leksion të hapur me Elda Vela nga Mediaprint, ku u diskutuan librat “Para të Prishura”

dhe Ditari i CEO-s. Ky aktivitet krijoi një hapësirë reflektimi mbi ekonominë, financën, leadershipin dhe zhvillimin personal, duke nxitur kulturën e leximit dhe mendimin kritik.

Përtej aktiviteteve akademike, klubi solli edhe një dimension kulturor përmes vizitës në ekspozitën Përmes Teje në Dritë të artistes Lidia Thimjo në Agimi Art Center. Kjo eksperiencë i ndihmoi studentët të reflektonin mbi rolin e artit dhe kulturës në formimin e mendimit kritik dhe në zgjerimin e perspektivës së tyre.

Një tjetër moment i rëndësishëm ishte debati i zhvilluar në bashkëpunim me klubin “Philip Kotler”, me temën “Gen Z in the Workplace: People vs Profit”. Studentët diskutuan mbi sfidat dhe pritshmëritë e brezit të ri në tregun e punës, duke analizuar balancën mes mirëqenies së punonjësve dhe performancës organizative.

Viti u përmbyll me një trajnim profesional nga Manjola Islami e Grant Thornton mbi standardin IFRS 9, ku studentët u njohën me konceptin e humbjeve të pritshme

të kreditit dhe aplikimin praktik të tyre përmes ushtrimeve në Excel.

Në tërësi, Klubi “Adam Smith” u shndërrua në një hapësirë dinamike ku studentët jo vetëm pasuruan njohuritë akademike, por zhvilluan edhe aftësi praktike, analitike dhe komunikuese, duke u afruar më shumë me realitetin e botës profesionale.

Përgatitur nga:

Greis Kanani

Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Departamenti i Juridikut, profil”Drejtësi”.

Studente e vitit të dytë

J301

Forumi i Studentëve të Financës:



Kur Studentët e UET
Analizojnë Tregjet Globale

Edicioni i XV-të i Forumit të Studentëve të Financës u zhvillua në UET me një temë që prek të gjithë: “Tregjet financiare përballë goditjeve dhe pasigurive”.

I organizuar nga Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në bashkëpunim me Economic Fundamentals Initiative (EFI), Center for Education and Development (CED) dhe Raiffeisen Bank, forumi mbledhi studentë, pedagogë dhe ekspertë për të diskutuar sfidat e ekonomisë globale.



Nga teoria në analizë reale

Studentët e UET prezantuan ese dhe analiza kritike mbi çështje që lidhen me tregjet financiare, politikat ekonomike dhe sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm. Punimet e tyre reflektuan aftësi analitike dhe mendim kritik mbi proceset që ndikojnë ekonominë globale dhe atë shqiptare. Në fokus ishte roli i brezit të ri të ekonomistëve në interpretimin e zhvillimeve bashkëkohore.

Zërat që orientuan debatin

Dekania Prof. Asoc. Dr. Elona Shehu vlerësoi angazhimin e studentëve dhe rëndësinë e lidhjes mes teorisë në auditor dhe realitetit ekonomik. Juria profesioniste, e përbërë nga Dr. Teuta Çerpja, Elton Korbi, Mimoza Kaçi dhe Armenisa Kadiasi, ndau perspektiva mbi sfidat aktuale të ekonomisë. Dr. Çerpja theksoi se formimi i specialistëve që dinë të interpretojnë të dhënat dhe të propozojnë zgjidhje të qëndrueshme është një nga objektivat kryesorë të arsimit universitar në këtë fushë.



Vajzat dominojnë podiumin

Momenti kulmor ishte shpallja e fitueseve të konkursit tradicional “Eseja më e mirë”. Edhe këtë vit, podiumi u dominua tërësisht nga vajzat, duke dëshmuar përgatitjen dhe nivelin e lartë akademik të studenteve. Tri studentet fituese u vlerësuan me çmime monetare dhe me një mundësi internshipi pranë Raiffeisen Bank një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit profesional dhe integritetit në tregun e punës.



Përgatitur nga:

Greis Kanani

Fakulteti i Shkencave Juridike,
Politike dhe Marrëdhënieve
Ndërkombëtare

Departamenti i Juridikut,
profil”Drejtësi”.

Studente e vitit të tretë

J301

Intervista me Mentoren e Klubit të Psikologjise "Freud" -Redona Dudushi



Aty ku psikologjia kthehet në mbështetje dhe zhvillim

Në një kohë kur studentët përballen me sfida akademike, emocionale dhe sociale, hapësirat që nxisin mbështetjen dhe zhvillimin personal marrin një rëndësi të veçantë. Klubi i Psikologjisë "Freud" është një prej këtyre hapësirave, ku studentët kanë mundësinë të shkëmbejnë ide, të zhvillojnë mendimin kritik dhe të krijojnë lidhje të vlefshme me njëri-

tjetrin.

Mentorja e klubit u bë pjesë e këtij rrugëtimi pasi iu propozua kjo mundësi, të cilën e pranoi me kënaqësi. Sipas saj, mentorimi luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe personal të studentëve, duke krijuar një lidhje më të afërt mes teorisë dhe praktikës në psikologji.

Universiteti është një periudhë e mbushur me ndryshime, përgjegjësi dhe sfida. Për këtë arsye, psikologjia ndihmon studentët të kuptojnë më mirë emocionet, sjelljen dhe marrëdhëniet me të tjerët. Zhvillimi i vetëbesimit, aftësive komunikuese dhe mirëqenies emocionale janë disa nga aspektet ku kjo fushë ndikon drejtpërdrejt në jetën e tyre.

Një nga përvojat më domethënëse për mentoren ka qenë bashkëpunimi me studentët e klubit. Ajo kujton me vlerësim energjinë, dëshirën për të mësuar dhe angazhimin që anëtarët kanë treguar që në takimet e para. Po aq të rëndësishme kanë qenë edhe aktivitetet me të ftuar, iniciativat e propozuara nga vetë studentët dhe komunikimi i vazhdueshëm që ka krijuar një ndjenjë komuniteti brenda klubit.

Duke folur për inteligjencën emocionale, ajo thekson se suksesi nuk duhet të lidhet vetëm me rezultatet akademike apo profesionale. Çdo individ zotëron forma të ndryshme inteligjence dhe pikërisht vlerësimi i këtij diversiteti ndihmon në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe më të balancuar.

Për mentoren, krijimi i një ambienti të sigurt emocional në universitet është thelbësor. Studentët kanë nevojë të ndihen të pranuar, të mbështetur dhe të lirë për të shprehur mendimet e tyre. Vetëm në një mjedis të tillë ata mund të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë.

Në lidhje me shëndetin mendor, ajo beson se të rinjtë kanë një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e shoqërisë. Përmes aktiviteteve, diskutimeve dhe rrjeteve sociale, ata mund të kontribuojnë në thyerjen e paragjykimëve dhe në promovimin e një kulture më të hapur dhe empatike.

Nëse do ta përshkruante Klubin “Freud” me tre fjalë, ato do të ishin: mbështetje, zhvillim dhe bashkëpunim. Tre vlera që pasqyrojnë më së miri frymën e klubit dhe ndikimin e tij te studentët.

Mesazhi i saj për të gjithë ata që hezitojnë të përfshihen është i thjeshtë, por domethënës: Është krejt normale të hezitosh. Shpesh nuk ka nevojë të jesh gati për t'u përfshirë; vetë përfshirja të ndihmon të bëhesh gati. Në fund të fundit, vitet universitare janë një mundësi unike për të mësuar, për të krijuar eksperiencë të reja dhe për të zbuluar potencialin që secili mban brenda vetes.

Intervista me Mentoren e Klubit të Menaxhimit “Peter Drucker” –Mishela Rapo



1. Si ka evoluar Klubi i Menaxhimit “Peter Drucker” që nga krijimi i tij?

Klubi i Menaxhimit “Peter Drucker” ka evoluar vazhdimisht që nga krijimi i tij, duke u shndërruar nga një hapësirë e fokusuar kryesisht te leksionet e hapura me profesionistë, në një platformë dinamike që ndërthur diskutimet akademike me aktivitetet praktike. Përmes leksioneve me

ekspertë nga fusha të ndryshme, workshop-eve teknologjike, debateve studentore, aktiviteteve kulturore dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare, klubi ka zgjeruar vazhdimisht ndikimin e tij, duke u ofruar studentëve mundësi të vlefshme për zhvillim profesional dhe personal.

2. Çfarë lloj studentësh kërkon më shumë të përfshijë klubi?

Klubi i Menaxhimit synon të përfshijë studentë aktivë, kreativë dhe me dëshirë për të mësuar përtej auditorit, veçanërisht studentë që kanë interes për menaxhimin, marketingun, sipërmarrjen, teknologjinë, komunikimin dhe zhvillimin personal. Kjo reflektohet edhe në larmishmërinë e aktiviteteve të organizuara. Për shembull, studentët e interesuar për teknologjinë dhe zhvillimet digjitale janë përfshirë në workshop-in “E ardhmja e Marketingut: Inteligjenca Artificiale dhe Automatizimi”, ku u diskutua përdorimi i inteligjencës artificiale dhe automatizimit në strategjitë moderne të marketingut. Ndërkohë, studentët që kanë interes për kulturën, artin dhe reflektimin social kanë marrë pjesë në

ekspozitën “Përmes teje në dritë” nga Lidia Thimjo, si edhe në aktivitetin pranë Muzeut Historik Kombëtar mbi fotografinë dhe kujtesën kolektive, ku u vizitua ekspozita e Jutta Benzenberg “Mos kthe kokën nga shtëpia që digjet” dhe u zhvillua workshop-i “Kujtesa e fotografuar dhe kujtesa kolektive”.

3. Si ndikon pjesëmarrja në klub në përgatitjen e studentëve për tregun e punës?

Pjesëmarrja në klub i ndihmon studentët të zhvillojnë aftësi praktike dhe profesionale që kërkohen në tregun e punës, si komunikimi, puna në grup, networking, prezantimi i ideve dhe mendimi kritik.

Një shembull konkret është aktiviteti “Ura Juaj drejt Tregut të BE-së”, ku studentët patën mundësinë të takojnë ekspertë të rrjetit Enterprise Europe Network dhe të diskutojnë mbi startup-et, financimet dhe tregun european. Po ashtu, përmes pjesëmarrjes në START UP STORM UET, studentët janë nxitur të zhvillojnë ide inovative dhe të mendojnë në mënyrë sipërmarrëse.

4. Cili është projekti apo iniciativa për të cilën ndiheni më krenare si mentore?

Një nga iniciativat për të cilat ndihem më krenare është bashkëpunimi ndërkombëtar me Universitas Negeri Surabaya, përmes organizimit të leksioneve të hapura me Prof. Jaka Nugraha në temat “From Perception to Positioning: The Strategic Power of Market Research” dhe “Generation AI: Job Crafting by Entry-Level Professionals in the Age of Generative AI”. Këto aktivitete jo vetëm që i ekspozuan studentët ndaj zhvillimeve më të fundit në fushën e marketingut dhe inteligjencës artificiale, por gjithashtu u dhanë mundësinë të diskutojnë dhe të shkëmbejnë ide me studentë të huaj, duke i analizuar këto çështje edhe nga një perspektivë ndërkombëtare dhe ndërkulturore. Përmes këtij bashkëpunimi, studentët patën mundësinë të kuptojnë më mirë mënyrën se si teknologjia, tregu i punës dhe strategjitë e marketingut po transformohen globalisht.

5. Çfarë metodash përdorni për t'i bërë diskutimet dhe aktivitetet sa më interaktive?



Për të krijuar aktivitete sa më interaktive përdoren analiza rastesh, diskutime në grup, debate, analiza filmash dhe reflektime praktike.

Për shembull, gjatë aktivitetit mbi audiobook-un “Who Moved My Cheese?” studentët diskutuan mbi mënyrën si individët reagojnë ndaj ndryshimit dhe sfidave profesionale. Ndërsa gjatë analizës së filmit The Social Network, studentët diskutuan mbi sipërmarrjen, leadershipin dhe ndikimin e rrjeteve sociale në biznesin modern.

6. Sa ndikim kanë idetë dhe iniciativat e vetë studentëve në organizimin e klubit?

Studentët kanë një rol shumë të rëndësishëm në përzgjedhjen e temave dhe organizimin e aktiviteteve. Shpesh aktivitetet zhvillohen bazuar në interesat dhe sugjerimet e tyre.

Për shembull, interesi i studentëve për transformimet në tregun e punës dhe kulturën organizative ndikoi në organizimin e debatit “Gen Z in the Workplace: People vs Profit”. Po ashtu, interesimi për temat sociale dhe inovacionin ndikoi në përfshirjen e studentëve në aktivitetet e sipërmarrjes sociale dhe startup-eve.

7. Çfarë aftësie mendoni se studentët zhvillojnë më shumë përmes këtij klubi? Një nga aftësitë që studentët zhvillojnë më shumë është mendimi kritik dhe aftësia për të argumentuar.

Kjo u reflektua shumë qartë gjatë debatit mbi Gjeneratën Z në vendin e punës, ku studentët analizuan dy këndvështrime të ndryshme mbi mirëqenien e punonjësve dhe rëndësinë e profitit për organizatat.

Përmes këtyre aktiviteteve ata mësojnë të mbështesin argumentet me shembuj konkretë dhe të diskutojnë në mënyrë profesionale.

8. Si i ndihmon klubi studentët të fitojnë më shumë besim në vete dhe aftësi komunikimi?

Klubi i Menaxhimit i ndihmon studentët të fitojnë më shumë besim në vete dhe aftësi komunikimi duke krijuar një ambient ku ata inkurajohen të shprehin mendimet, të argumentojnë idetë dhe të marrin pjesë aktivisht në diskutime dhe bashkëpunime të ndryshme. Përmes përfshirjes në aktivitete interaktive, diskutime akademike dhe bashkëpunime ndërkombëtare, studentët zhvillojnë aftësinë për të komunikuar në mënyrë më profesionale, për të punuar në grup dhe për të prezantuar mendimet e tyre me më shumë siguri. Gjithashtu, ndërveprimi me studentë dhe profesionistë nga kontekste të ndryshme i ndihmon ata të jenë më të hapur, më të sigurt dhe më të përgatitur për sfidat e komunikimit në mjedise akademike dhe profesionale.

9. A ka pasur raste kur studentët e klubit kanë realizuar projekte apo ide me ndikim real?

Po, studentët kanë qenë pjesë e iniciativave me ndikim konkret, sidomos në fushën e sipërmarrjes dhe inovacionit social. Një shembull i rëndësishëm ishte bashkëpunimi i Klubit të Menaxhimit me People in Focus në kuadër të Hackathonit Kombëtar mbi Sipërmarrjen Sociale, ku studentët punuan në ekipe për të zhvilluar ide kreative dhe zgjidhje që adresonin problematika reale të komunitetit. Përmes këtij aktiviteti, ata zhvilluan aftësi praktike si puna në grup, prezantimi i ideve, zgjidhja e problemeve dhe mendimi inovativ. Gjithashtu, pjesëmarrja në aktivitete të lidhura me sipërmarrjen dhe startup-et i ka ndihmuar studentët të krijojnë kontakte profesionale, të shkëmbejnë ide dhe të zhvillojnë projekte me potencial praktik dhe social.

10. Si e imagjinoni zhvillimin e klubit në vitet e ardhshme dhe cilat janë objektivat kryesore?

Në vitet e ardhshme synimi është që klubi të ketë edhe më shumë bashkëpunime ndërkombëtare dhe aktivitete praktike që lidhen me zhvillimet e tregut dhe teknologjisë.

Objektivat kryesore janë zgjerimi i workshop-eve praktike, përfshirja më e madhe e studentëve në projekte reale, organizimi i aktiviteteve mbi inteligjencën artificiale, sipërmarrjen dhe zhvillimin e aftësive digjitale, si edhe krijimi i më shumë hapësirave për diskutime ndërdisiplinore mes biznesit, kulturës dhe teknologjisë.

11. Si e keni përjetuar personalisht eksperiencën tuaj si mentore e Klubit të Menaxhimit dhe çfarë keni reflektuar apo mësuar nga puna me studentët?

Eksperienca si mentore ka qenë shumë motivuese dhe një proces i vazhdueshëm reflektimi. Puna me studentët më ka treguar se ata angazhohen më shumë kur aktivitetet janë praktike, aktuale dhe interaktive.

Kam reflektuar se studentët kanë nevojë për hapësira ku mund të diskutojnë lirshëm, të provojnë idetë e tyre dhe të ndihen pjesë aktive e procesit. Aktivitetet

e organizuara gjatë këtyre viteve kanë treguar se kur studentëve u jepet mundësia të kontribuojnë dhe të përfshihen realisht, ata tregojnë kreativitet, përgjegjësi dhe potencial shumë të madh profesional.

Përgatitur nga:

Irini Tollumi,

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale,

Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, profil “Marketing”

Studente e vitit të dytë

KOM201



Në një kohë kur inteligjenca artificiale dhe transformimi digjital po ndryshojnë çdo aspekt të jetës sonë, një pyetje vazhdon të jetë e rëndësishme:

ku janë vajzat në këtë revolucion? Për t'i dhënë përgjigje dhe për t'i inkurajuar ato të hyjnë në botën e teknologjisë, Universiteti European i Tiranës organizoi një aktivitet të veçantë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Vajzave në ICT, duke sjellë së bashku studente, pedagoge, alumne të suksesshme dhe sipërmarrëse të sektorit.

Pse duhet të flasim për vajzat në teknologji?

Pjesëmarrja e vajzave në fushat STEM (Shkenca, Teknologji, Inxhinieri, Matematikë) dhe ICT (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi) mbetet një faktor kyç për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Aktiviteti synoi të nxisë më shumë vajza të zgjedhin karrierën në teknologji dhe të besojnë në potencialin e tyre për të qenë lidere, krijuese dhe sipërmarrëse. Mesazhi kryesor ishte i qartë: teknologjia nuk ka gjini. Kur vajzat dhe gratë kanë mundësi të barabarta për të studiuar, krijuar dhe udhëhequr në sektorin e teknologjisë, përfiton e gjithë shoqëria.

Zëri i dekanes: Barazia nuk është thjeshtë numër

Dekania e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, Prof. Asoc. Dr. Teuta Xhindi, theksoi rëndësinë e krijimit të mundësive të barabarta për vajzat në fushat teknologjike. Sipas saj, barazia gjinore në STEM nuk është thjesht një objektiv statistikor, por një domosdoshmëri për progresin dhe inovacionin. “Ne duam që vajzat jo vetëm të hyjnë në këto fusha, por të zhvillojnë rrugëtimin e tyre deri në nivelet më të larta profesionale, duke u bërë sipërmarrëse, drejtuese dhe krijuese të vlerës,” u shpreh ajo. Fjalët e saj ishin një thirrje për të mos u mjaftuar me praninë simbolike, por për të synuar vendet e vendimmarrjes.



Nga bankat e UET drejt suksesit: Historitë që frymëzojnë

Një moment i rëndësishëm i aktivitetit ishte ndarja e përvojave personale dhe profesionale nga alumne të suksesshëm të UET. Kristina Çalaku dhe Albina Hoxha folën për sfidat, mundësitë dhe mësimet që kanë përfituar gjatë rrugëtimit të tyre nga auditoret universitare drejt tregut të punës. Mesazhi i tyre për studentet ishte i thjeshtë por i fuqishëm: “Mos u mjaftoni me aq sa keni, thellohuni gjithmonë më shumë.” Ato theksuan se vajzat sjellin një perspektivë unike në teknologji përmes kreativitetit, vëmendjes ndaj detajeve dhe aftësisë për të zgjidhur probleme komplekse. Për studentet në sallë, kjo ishte dëshmi e gjallë se rruga nga universiteti drejt suksesit është reale dhe e mundur.



Më shumë se një aktivitet: Një komunitet që mbështet

Përmes diskutimeve, bashkëbisedimeve dhe rrjetëzimit mes pjesëmarrësve, aktiviteti krijoi një hapësirë ku studentet mund të njihnin njëra-tjetrën, të ndanin përvoja, të gjenin mentore dhe të kuptonin se nuk janë vetëm. U evidentua rëndësia e krijimit të një komuniteti mbështetës për vajzat që synojnë të ndërtojnë karrierë në ICT. Gjithashtu, aktiviteti konfirmoi edhe një herë rolin e UET si një institucion që jo vetëm ofron arsim cilësor, por edhe mbështet studentët dhe të diplomuarit e tij në zhvillimin profesional, lidhjen me industrinë dhe krijimin e mundësive të reja për sukses.





Kur kodimi nis që nga çerdhet: Një ftesë për ndryshim

Një perspektivë tjetër frymëzuese solli Megi Trashani, themeluese e Coddy School Tirana. Ajo foli mbi rëndësinë e edukimit të hershëm në programim dhe teknologji, duke theksuar se krijimi i interesit për kodimin që në moshë të vogël është një hap i rëndësishëm për të rritur përfaqësimin e vajzave në sektor. “Duhet të ndryshojmë mendësinë që vajzat të jenë pjesë e teknologjisë që në hapat e parë të edukimit të tyre. Sa më herët të krijohen këto mundësi, aq më i madh do të jetë ndikimi i tyre në të ardhmen,” u shpreh ajo. Ftesa e saj ishte e qartë: ndryshimi fillon me edukimin, dhe sa më shpejt të thyhen stereotipet, aq më shpejt do të shohim rezultate.

Teknologjia nuk ka gjini

Në përfundim, mesazhi i aktivitetit ishte i qartë dhe i fuqishëm. Fryma e sallës, pyetjet e studenteve, historitë e alumneve dhe fjalët e sipërmarrëseve krijuan një atmosferë ku ambicia nuk njihte kufij. Sepse në fund të ditës, suksesi në teknologji nuk varet nga gjinia, por nga kurioziteti, vendosmëria dhe vullneti për të mësuar gjithmonë më shumë. Dhe UET-i dëshmoi se është i gatshëm të ecë përkrah çdo studente që zgjedh të ndjekë këtë rrugë.



Përgatitur nga:

Greis Kanani

Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe
Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Departamenti i Juridikut, profil "Drejtësi".

Studente e vitit të tretë

J301

Trainimi i OSBE-së për Barazinë Gjinore:

*Kur
Stereotipet
Përballen me Faktin*



Më 9 Mars, në kuadër të Ditës

Ndërkombëtare të Gruas, UET-i priti një trajnim të veçantë mbi barazinë gjinore. Aktiviteti u zhvillua në bashkëpunim me OSBE-në dhe Grupin Këshillimor të të Rinjve (YAG), me synimin kryesor për të nxitur dialogun dhe të menduarit kritik te të rinjtë.



Kush qëndron pas tij?

Një nga organizatorët ishte Joni Shtambari, student i UET dhe anëtar i YAG. Ai tregon se idea lindi nga nevoja për të luftuar disinformimin rreth ligjit të barazisë gjinore, i cili ishte keqinterpretuar nga mediat. “Universiteti është vendi ku të rinjtë janë më të hapur ndaj ideve të reja,” thotë Joni. Kështu, trajnim i parë u nis pikërisht nga kampuset.

Momentet më të forta

Trajnimi nuk ishte ligjërata monologe. Studentët debatuan hapur, ndërsa disa prej pikave më të nxehta ishin:


Çfarë morën me vete studentët?

Mesazhi kryesor ishte i qartë: mos bini pre e disinformimit dhe populizmit. Çdo informacion duhet konfrontuar me mendim kritik. Studentët e kuptuan se barazia gjinore nuk është thjesht një term abstrakt, por një çështje që prek çdo aspekt të jetës nga stereotipet te nevojat e grupeve të marginalizuar.



Në pak fjalë

Trajnimi solli debate, reagime dhe reflektime. Por mbi të gjitha, solli qartësi: barazia fillon kur e kuptojmë se çfarë na mban peng sidomos paragjykimet që i mbajmë pa e ditur.



Përgatitur nga:

Greis Kanani

Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe
Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Departamenti i Juridikut, profil "Drejtësi".

Studente e vitit të tretë

J301

Java Ndërkombëtare

Kur Botët Bashkohen
në një Kampus

Këtë vit, UET-i u shndërrua për disa ditë në një qendër ndërkombëtare. Java Ndërkombëtare e organizuar në kuadër të Erasmus+ solli në kampus studentë dhe pedagogë nga vende të ndryshme, duke krijuar një atmosferë ku kultura, idetë dhe miqësitë u bashkuan lehtësisht.

Çfarë ishte në fokus?

Qëllimi kryesor ishte i qartë: t'i tregohej komunitetit universitar se Erasmus+ nuk është thjesht një shkëmbim letërash midis universiteteve, por një mundësi reale për të njohur botën, për të zhvilluar veten dhe për të ndërtuar një rrjet miqsh ndërkombëtar. Gjatë javës u zhvilluan prezantime, sesione informuese rreth mobiliteteve, takime me stafin akademik dhe më e rëndësishmja aktivitete sociale ku studentët vendas dhe ata nga jashtë u njohën me njëri-tjetrin.

Jashtë skenës: Çfarë pa publiku?

Organizatorët e tregojnë qartë: një javë e tillë nuk ndodh vetë. Përkundrazi, kërkon planifikim, fleksibilitet dhe shumë punë në prapaskenë.

Një nga organizatorët, e cila kishte edhe rolin e koordinueses edhe atë të pjesëmarrësës, e përshkroi si një eksperiencë “dinamike dhe sfiduese.” Sfida më e madhe? Të kaloje nga “menaxherja që kontrollon çdo detaj” në “studenten që shijon atmosferën.”

Shumë gjëra mund të shkojnë ndryshe nga plani, por zgjidhjet duhet të gjenden shpejt pa t'i ndalur ritmin aktivitetit.

Si e përjetuan studentët?

Për studentët, kjo javë ishte më shumë se argëtim. Një prej tyre e quajti një “udhëtim mes kulturave të ndryshme.” Momenti më i bukur? Të shikonte studentë vendas dhe ndërkombëtarë duke biseduar lirshëm, duke qeshur dhe duke krijuar miqësi që vazhduan edhe pas mbylljes së aktivitetit.

Kjo tregoi diçka të rëndësishme: kur studentët bashkohen, kufijtë zhduken. Ata shkëmbyen kontakte, kultura dhe përvoja duke krijuar një atmosferë kaq të hapur sa që shumë prej tyre e ndjenë veten më të përgjegjshëm, më të organizuar dhe më të gatshëm për të bashkëpunuar me njerëz nga e gjithë bota.

Mesazhi që mbetet

Në fund të fundit, Java Ndërkombëtare dëshmoi se Erasmus+ është një eksperiencë transformuese jo vetëm për karrierën, por edhe për jetën.

Siç tha dikush aty: “Studentët kanë një fuqi të jashtëzakonshme për të sjellë ndryshim kur bashkohen.”

Dhe këtë e panë me sy të vetëm në korridoret, kafenetë dhe aktivitetet sociale të UET-it, ku për disa ditë, akademikja u takua me miqësinë, dhe kufijtë u bënë thjesht pika nisjeje.

Përgatitur nga:

Irini Tollumi,

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe

Arteve Liberale,

Departamenti i Shkencave Humane dhe

Komunikimit, profil “Marketing”

Studente e vitit të dytë

KOM201

UET
mirëpret
Erasmus+
Days
dhe
International
Staff Week



S
U
M
S
E
R
E

UET hap dyert për Erasmus+ Days dhe International Staff Week

Nga 13 deri më 17 Prill, Universiteti European i Tiranës (UET) u kthye për disa ditë në një qendër ndërkombëtare. U organizuan dy evenimente të rëndësishme: Erasmus+ Days dhe International Staff Week, ku studentë, pedagogë dhe staf akademik u bashkuan për të diskutuar rreth mundësive që ofron arsimi european.

Çfarë ofron Erasmus+ për studentët?

Aktivitetet kryesore u fokusuan tek studentët. Ata patën mundësinë të mësonin më shumë rreth programeve të shkëmbimit akademik, praktikave profesionale jashtë vendit dhe përvojave reale të studentëve që kanë qenë pjesë e Erasmus+. Përmes bisedave dhe prezantimeve, pjesëmarrësit u informuan se si të aplikojnë, çfarë vështirësish mund të hasin dhe çfarë përfitimesh sjell një eksperiencë jashtë vendit jo vetëm për studimet, por edhe për zhvillimin personal dhe profesional. Për shumë studentë, këto takime ishin një dritare për të parë nga afër perspektivat që ofron studimi jashtë Shqipërisë.

Java e Stafit Ndërkombëtar

Në të njëjtën kohë, në UET u zhvillua edhe International Staff Week, ku u mbledhën pedagogë dhe staf administrativ nga universitete partnere europiane. Java filloi me një aktivitet mikpritës ku u diskutua për inovacionin në arsimin e lartë dhe forcimin e bashkëpunimeve mes universiteteve. Gjatë javës u zhvilluan punëtori, diskutime dhe sesione ku pjesëmarrësit shkëmbyen përvoja rreth projekteve ndërkombëtare dhe praktikave akademike. Kjo krijoi një mundësi të mirë për të njohur njerëz të rinj dhe për të nisur bashkëpunime të reja.





Kultura dhe shoqëria

Pjesë e programit ishin edhe takimet e drejtpërdrejta me studentët, pjesëmarrja në “Ditët e Studimeve Shqiptare” dhe aktivitete kulturore në Tiranë. Pjesëmarrësit nga jashtë vendit eksploruan qytetin, njohën kulturën shqiptare dhe krijuan lidhje më të ngushta me komunitetin universitar. Kështu, kjo javë nuk ishte vetëm akademike, por edhe një përvojë kulturore dhe shoqërore.



Pse ka rëndësi?

Erasmus+ Days dhe International Staff Week treguan përsëri se sa e rëndësishme është bashkëpunimi ndërkombëtar në arsimin e lartë. Programet e shkëmbimit ndihmojnë studentët, pedagogët dhe institucionet të lidhen mes tyre, pavarësisht vendit ku ndodhen. Përtej informacionit dhe ligjëratave, kjo javë solli një frymë të hapur komunikimi dhe bashkëpunimi duke i inkurajuar të gjithë të shohin arsimin si një aventurë pa kufij

Dëshiron të marrësh pjesë në Erasmus+? Mbaj sytë hapur për njoftimet e UET dhe mos hezito të aplikosh një botë e re mund të jetë vetëm një formular larg

Redaktuar nga:

Grejsi Xhani

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale,

Departamenti i Arteve të Aplikuara, profil “Aktrim”.

Studente e vitit të dytë

AS201

Zanafilla e **DITURIUM Media Lab,** Nga **Prof. Dr. BELINA BUDINI**



Kur nisi viti akademik, nuk kishim në mendje thjesht dhe vetëm një revistë studentore, por një ide më të madhe. Për një hapësirë ku studentët të prodhojnë informacion dhe dije praktike. Kështu lindi Laboratori i Multimedias, i cili më pas mori formë dhe identitet si Diturium Media Lab, duke synuar të jetë një platformë universitare më e gjerë që përfshin gazetarinë, komunikimin, fotografinë, videon dhe një seri podkastesh në formën e

projekteve reale nga studentët dhe pedagogët e Departamentit të Shkencave Humane dhe Komunikimit në UET, në bashkëpunim me departamentet e tjera.

Si Dekane e Fakultetit të Shkencave Humane,



Revista “UET Chronicles” është dëshmi e këtij rrugëtimi, me studentët në rolin e reporterëve dhe artistëve grafikë. Në faqet e kësaj reviste janë paraqitur disa nga nismat dhe aktivitetet e klubeve të UET, si edhe intervista të shkollave sezonale të zhvilluara përgjatë vitit akademik 2025-2026. Unë po ndalem shkurt vetëm në njërin prej tyre, eventin që shënoi audicionin e parë të Diturium Media Lab, ku studentët prezantuan punët e tyre krijuese dhe sugjerimet për dinamikat e laboratorit të multimedias pranë UET. I zhvilluar në përfundim të semestrit të parë të këtij viti akademik, punët e prezantuara kishin formën e detyrave të kursit, por disa erdhën edhe si projekte ad hoc, të krijuara enkas për laboratorin.





Dinamika e krijuar u vijua edhe me punët e kursit të semestrit të dytë në lëndë si Marrëdhënie Publike Politike dhe Komunikim Organizativ, duke prezantuar ide të reja, video-reportazhe, episode të plota podkastesh të realizuara me regjinë, moderimin dhe montimin e vetë studentëve, si edhe postera, fletëpalosje e logo, plane e strategji marketingu, nën orientimin dhe vlerësimin e mentorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Këto produkte multimediale dhe ide komunikimi të zhvilluara përgjatë vitit janë tanimë pjesë e arkivës së laboratorit dhe shërbejnë si gur themeli për rritjen e potencialit praktik dhe publik të studentëve. Për shumë prej tyre ishte hera e parë që puna e realizuar në auditor u prezantua para një publiku më të gjerë, duke kaluar nga një detyrë kursi në një produkt real komunikimi.



Edukimit dhe Arteve Liberale, por edhe si mentore e këtyre nismave, kam pasur kënaqësinë të shoh se si studentët zhvillohen kur u jepet besim, përgjegjësi dhe liri krijuese. Pikërisht për këtë arsye, kjo revistë nuk shëmbëllen me një përmbledhje aktiviteteve. E konceptuar dhe krijuar me pasion dhe talent, revista dokumenton një proces didaktik e formues: nga ideja e parë, te intervista e parë, fotografia e parë profesionale, reportazhi i parë apo prezantimi i parë publik. Ndërsa jemi të rrethuar nga komunikimi në

të gjitha format, sikurse jam shprehur më tej edhe në intervistën për studenten e laboratorit, Irinin, që kujdeset për menaxhimin e rrjeteve sociale dhe marketingun e Diturium Media Lab, është me rëndësi që studentët të mësojnë t'i përdorin mjetet e medias, por edhe të kuptojnë përgjegjësinë që vjen bashkë me to. Kjo revistë tregon se ata kanë filluar ta bëjnë këtë.

Falënderoj studentët e Laboratorit të Multimedias dhe të Klubit të Komunikimit McLuhan për punën, përkushtimin dhe energjinë që kanë investuar në këtë botim, që është i dyti me logon e Diturium, pas tekstit bazë universitar të realizuar nga pedagogët në kuadër të modulit të ri të Projektit të Jean Monnet Chair, PROEUMEDAL. Libri me titull Media dhe Studime Europiane, shërben si bazë për reformimin e 12 lëndëve që burojnë nga 5 departamente të ndryshme studimi në UET dhe promovimi i tij u realizua nga studentët në bashkëpunim me pedagogët së fundi në Europe House. Këto botime si edhe kjo revistë u përkasin studentëve, por njëkohësisht shenjojnë historinë e një gjenerate të re prakticienësh që po e rrëfejnë botën duke u bërë pjesë aktive e saj.

Prof. Dr. Belina Budini
Dekane, Fakulteti i Shkencave Humane,
Edukimit dhe Arteve Liberale;
Drejtuese e Diturium Media Lab



Mentore:

Dokt. Erisela Marko, mentore e Klubit të Komunikimit “McLuhan”

Koordinatorë:

Sibora Këllezi, studente e vitit të tretë në degën Komunikim me profil Gazetari, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, UET.

Artikuj/Intervista:

Sibora Këllezi, studente e vitit të tretë në degën Komunikim me profil Gazetari, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, UET.

Greis Kanani, studente e vitit të tretë në degën Drejtësi, pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, UET.

Grejsi Xhani, studente e vitit të dytë në degën Arte Skenike, profil Aktrim, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, UET.

Irimi Tollumi, studente e vitit të dytë në degën Komunikim me Profil Marketing, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, UET.

Nejla Mjeshtri, studente e vitit të tretë në degën Shkenca Politike, pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, UET.

Fotografi:

Emil Nuka, student i vitit të dytë në degën Arte Pamore, profil Grafikë-Dizajn, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, UET.

Dizajni:

Irisa Abdiu, studente e vitit të dytë në degën Arte Pamore, profil Grafikë-Dizajn, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, UET.

Jon Kasaruho, student i vitit të dytë në degën Arte Pamore, profil Grafikë-Dizajn, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, UET.



MAIORA PREMUNT

Gjëra të
mëdha na
presin

